

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

2023

RAPORT VJETOR

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

PËRMBAJTJA


SHKURTIME	4
TERMINOLOGJIA	4
I. MESAZHI I KOMISIONERIT DHE VIZIONI	7
II. KORNIZA LIGJORE	8
III. E DREJTA PËR INFORMIM	9
III.1 MONITORIMI I TRANSPARENCËS	10
III.1.1 Transparenca proaktive në sektorin e arsimit.....	13
III.2 Indekset e Transparencës Proaktive	13
III.2 PROCESI MBIKËQYRËS	15
III.2.1 Trajtimi i ankesave	15
III.2.2 Vendimmarrja.....	16
III.3 INSTRUMENTET ELEKTRONIKE	18
III.4 TË DHËNAT E HAPURA DHE RIPËRDORIMI I INFORMACIONIT, NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK.....	18
IV. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE	20
IV.1 MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA	21
IV.1.1 Trajtimi i ankesave.....	21
IV.1.2 Hetimi administrativ	21
IV.1.3 Vendimmarrja	25
IV.2 TRANSFERIMI NDËRKOMBËTAR.....	26
IV.3 REGJISTRI I NJOFTIMEVE	26
V. ROLI I ZYRËS SË KOMISIONERIT NË KONTEKSTIN E BRENDSHËM	27
V.1 MARRËDHËNIET ME KUVENDIN E SHQIPËRISË	27
V.1.1 Zbatimi i Rezolutës	27
V.1.2 Roli i institucionit në veprimtarinë e Kuvendit	28
V.2 PËRPUTHSHMËRIA E AKTEVE RREGULLATORE ME LEGJISLACIONIN PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE	28
VI. ROLI I ZYRËS SË KOMISIONERIT NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE	30
VI.1 PROCESI I INTEGRIMIT EVROPIAN	30
VI.1.2 Udhërrëfyesit.....	31
VI.1.3 Progres Raporti i Komisionit Evropian.....	31
VI.1.4 Raportime periodike në kuadër të procesit të integritimit.....	32
VI.2 MISIONI I VLERËSIMIT TË BE (<i>Peer Mission Review</i>).....	33
VI.3 PJESËMARRJA NË FORUME DHE RRJETE NDËRKOMBËTARE	33
VI.3.1 Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit (ICIC).....	33
VI.3.2 Asambleja Globale e Privatësisë (GPA)	34
VI.3.3 Bashkëpunimi me Eurojust	35
VI.3.4 Bashkëpunimi Rajonal	35

VI.3.5 Pjesëmarrje në forume të tjera	36
VII. NDËRGJEGJËSIMI DHE PROMOVIMI I TË DREJTAVE	38
VII.1. DITËT NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE	38
VII.2 AKTIVITETE NDËRGJEGJËSUESE	39
VII.3 BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE.....	41
VII.4. AKTIVITETE TË TJERA	42
VIII. VEPRIMTARIA JURIDIKE, PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE	44
VIII.1 AKTE RREGULLATORE.....	44
VIII.1.1 Ligji i ndryshuar për të drejtën e informimit	44
VIII.1.2 Projektligji për mbrojtjen e të dhënave personale	44
VIII.1.3 Udhëzimi 463/2020	45
VIII.1.4 Udhëzuesi “Për përpunimin e të dhënave personale në kontekstin e fushatave zgjedhore”	45
VIII.2 DOKUMENTE STRATEGJIKE	45
VIII.2.1 Strategjia Institucionale 2022-2025.....	45
VIII.2.2 Plani i Integritetit 2022-2025	45
VIII.2.3 Strategji Ndërsektoriale	46
VIII.3 PROCESE GJYQËSORE.....	47
IX. MENAXHIMI BUXHETOR	49
IX.1 STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE	49
IX.2 MENAXHIMI I BUXHETIT.....	49

SHKURTIME**TERMINOLOGJIA**

AFMIS	Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Financave Publike
AP	Autoritete Publike
AMS	Sistemi i Menaxhimit të Aplikimit – Application Management System
BE	Bashkimi Evropian – European Union
Direktiva e Policisë	Direktiva (BE) 2016/680 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 27 prillit 2016 <i>“Për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”</i>
DPO	Nëpunësi për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
GDPR	Rregullore (BE) nr. 2016/679 <i>“Për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”</i> – General Data Protection Regulation
GPA	Asambleja Globale e Privatësisë – Global Privacy Assembly
IAL	Institucione të Arsimit të Lartë
ICIC	Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit – International Conference of Information Commissioner
KiE	Këshilli i Evropës – Council of Europe
KKIE	Këshilli Kombëtar i Integritimit Europian
Ligji për të drejtën e informimit, i ndryshuar	Ligji nr. 119/2014 <i>“Për të drejtën e informimit”</i> , i ndryshuar me ligjin nr.78, datë 21.09.2023 <i>“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”</i>
Ligji për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik	Ligji nr. 33/2022 <i>“Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”</i>
Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale	Ligji nr. 9887/2008 <i>“Për mbrojtjen e të dhënave personale”</i> , i ndryshuar
Ligji nr. 49/2022	Ligji nr. 49/2022, datë 12.05.2022, <i>“Për ratifikimin e Protokollit ndryshues të Konventës “Për mbrojtjen e individëve, në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale (Konventa 108+)”</i>
Ligji nr. 45/2022	Ligji nr. 45/2022, datë 28.04.2022 <i>“Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumenta zyrtare (Konventa 205)”</i>

NjVV	Njësi të Vetëqeverisjes Vendore
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PT	Programi i Transparencës, tërësia e informacionit dhe mënyrat e bërjes publike të tij nga autoriteti publik, sipas përcaktimeve të neneve 4 dhe 7 të ligjit për të drejtën e informimit, i ndryshuar
QSHA	Qendra e Shërbimeve Arsimore
REKPDI	Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit
Rezoluta e Kuvendit	Rezolutë për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2023, miratuar me datë 08.06.2023
SMSI	Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit
SMIP	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar
Udhëzim nr. 47/2018	Udhëzim nr. 47, datë 14.09.2018 <i>“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”</i>
Udhëzim nr. 48/2018	Udhëzim nr. 48, datë 14.09.2018 <i>“Për certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”</i>
Urdhër nr. 14/2015	Urdhër nr. 14, datë 22.01.2015 <i>“Për miratimin e Programit model të Transparencës”</i>
Urdhër nr. 211/2018	Urdhër nr. 211, datë 10.09.2018 <i>“Programi model i Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”</i>
Urdhër nr. 187/2020	Urdhër nr. 187, datë 18.12.2020 <i>“Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”</i> .
Urdhër nr. 188/2020	Urdhër nr. 188, datë 18.12.2020 <i>“Për miratimin e Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të rishikuar”</i>
VKM nr. 145/2018	Vendim i Këshillit të Ministrave nr.145/2018 <i>“Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore “Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të drejtën e informimit””</i>
Vendimi i Kuvendit nr. 24/2023	Vendim i Kuvendit të Republikës të Shqipërisë, nr. 24/2023 <i>“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale””</i>
Zyra e Komisionerit	Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale



KOMISIONERI PË
E INFORMIMIT DH
E TË DHËNAVE PE

STATISTIKA VJETORE

ANKESA

1398

REKPMI

222

**KONTROLLUES TË
REGJISTRUAR**

5956

DPO

435

73 VENDIME

DHËNIE MENDIMI

39 REKOMANDIME

16 AKTE LIGJORE/ NËNLIGJORE

30 OPINIONE

**106 SEANCA
DËGJIMORE**

INSPEKTIVE NË TERREN

110

www.idp.al

I. MESAZHI I KOMISIONERIT DHE VIZIONI

Viti 2023 për Zyrën e Komisionerit shënoi një tjetër hap të rëndësishëm në konsolidimin e kuadrit ligjor në fushën e të drejtës për informim, ndërsa presim përmbylljen e procesit të modernizimit tërësor të tij në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Kontributi i institucionit në forcimin e kulturës së transparencës e llogaridhënies së autoriteteve publike dhe integritetit e përgjegjshmërisë së kontrolluesve ishte intensiv e konstant, paralelisht, me avancimin e përpjekjeve për promovimin e ushtrimit në praktikë të këtyre dy të drejtave dhe lirive themelore. Nuk mund të ketë shoqëri të përparuar demokratike pa garantimin e respektimit të tyre, çka ndikon në zhvillimin ekonomik-shoqëror të vendit.

Për realizimin e misionit të saj, Zyra e Komisionerit udhëhiqet nga parimi i forcimit dhe rritjes së aftësive profesionale dhe etike të stafit. Qasja e institucionit është për edukim të vazhdueshëm, duke përqafuar metodat më bashkëkohore dhe inovative në funksion të ushtrimit efikas të veprimtarisë së tij.

Bashkëpunimi është gur themeli në marrëdhëniet tona, si me qytetarët ashtu edhe me autoritetet publike, kontrolluesit publik e privat, shoqërinë civile apo grupet e interesit, duke marrë në konsideratë edhe këndvështrimin e tyre. Rezultati maksimal është i mundur të arrihet duke ndërvepruar, diskutuar, shkëmbyer eksperiencë dhe opinione, duke garantuar në çdo rast standardet e arritura.

Ndikimi në shoqëri i rolit të Zyrës së Komisionerit është arritur nëpërmjet performancës së saj ndër vite, me objektiva të qarta dhe me masa konkrete. Arritja e suksesit varet nga mënyra se si reflektohet mbi problematikat e të kaluarës, e kombinuar kjo edhe me praktikatat më të mira për vendimmarrje sa më efektive. Kjo kulturë pune kërkohet të përqafohet edhe nga autoritetet/kontrolluesit publik dhe subjektet private, në funksion të respektimit të të drejtave të qytetarëve.

Fokusi ynë mbetet inkurajimi për marrjen e masave proaktive, zbatimin e parimeve për mbrojtjen e të dhënave personale në integrimin e teknologjisë, si dhe rritjen e llogaridhënies për pjesëmarrje të qytetarëve në qeverisje.

Mbajtja e edicionit të 15-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit, në datat 3-5 qershor 2024 në Tiranë, përbën shprehje të besimit, vlerësimit dhe tregues për arritjen e standardeve bashkëkohore të institucionit në këtë fushë. Ky aktivitet madhor, që zhvillohet për herë të parë në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, synon të promovojë fuqizimin e rolit të individit përmes aksesit në informacion në një botë gjithnjë e më të ndërlikuar. Konferenca do të bëjë bashkë të gjithë aktorët që japin kontribut aktiv në konsolidimin e transparencës, si një mundësi unike për ta shtrirë këtë qasje akoma edhe më shumë në vendin tonë.

Arritjet e deritanishme na motivojnë të forcojmë mjedisin bashkëpunues, ku informacioni cilësor shërben si një katalizator për një ekonomi më të zhvilluar dhe inovative, shoqëri të hapur e demokratike për garantimin e të drejtave të qytetarëve.

II. KORNIZA LIGJORE

Korniza ligjore që rregullon fushat e përgjegjësisë, kompetencat dhe funksionimin e Zyrës së Komisionerit, mbështetet në akte kombëtare dhe ato ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë. Ky kuadër është konsoliduar dhe zgjeruar ndër vite, duke rritur si peshën e autoritetit në arkitekturën institucionale të vendit, ashtu edhe vetëdijen e përgjegjshmërinë tonë për rolin thelbësor që kemi në shoqëri për garantimin e dy të drejtave themelore. Më poshtë gjendet legjislacioni ku bazohet veprimtaria institucionale:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 23 garanton të drejtën për informim dhe neni 35 garanton mbrojtjen e të dhënave personale;
- Ligji nr. 8137/1996 *“Për ratifikimin e Konventës evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9288/2004 *“Për ratifikimin e Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 49/2022 *“Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”*;
- Ligji nr. 45/2022 *“Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare”*;
- Ligji nr. 9887/2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 108/2014 *“Për policinë e shtetit”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 146/2014 *“Për njoftimin dhe konsultimin publik”*;
- Ligji nr. 19/2016 *“Për masat shtesë të sigurisë publike”*;
- Ligji nr. 15/2016 *“Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”*;
- Ligji nr. 60/2016 *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*;
- Ligji nr. 71/2016 *“Për kontrollin kufitar”*;
- Ligji nr. 113/2018 *“Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”*;
- Ligji nr. 72/2019 *“Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”*;
- Ligji nr. 33/2022 *“Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”*.

III. E DREJTA PËR INFORMIM

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në Seancën Plenare të datës 21.09.2023, miratoi ligjin nr. 78/2023 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”*”, duke finalizuar një proces disa-vjeçar konsultimi me qytetarë, shoqërinë civile, grupet e interesit dhe autoritete publike. Numri i lartë i konsultimeve publike është tregues i qartë i rëndësisë që ka legjislacioni për të drejtën e informimit për demokratizimin e mëtejshëm të shoqërisë shqiptare, njohjes dhe përdorimit të tij.

Këto ndryshime dhe përmirësime adresojnë problematikat e konstatuara përgjatë periudhës së zbatimit të këtij ligji, duke standardizuar akoma edhe më mirë ushtrimin në praktikë të të drejtës për informim. Modernizimi i kuadrit rregullator kombëtar në këtë fushë ka të njëjtën frymë dhe qasje edhe me Konventën e Këshillit të Evropës *“Për aksesin në dokumente zyrtare”*, miratuar nga Kuvendi me ligjin nr. 45/2022. Gjithashtu, në muajin prill të vitit 2023, hyri në fuqi ligji nr. 33/2022 *“Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”*, duke i shtuar një kompetencë të re Zyrës së Komisionerit në mbikëqyrjen dhe promovimin e kësaj të drejte. Nëpërmjet tij garantohet një politikë e qartë dhe e posaçme në këtë drejtim, duke inkurajuar disponueshmërinë e gjerë dhe mundësinë e ripërdorimit të informacionit të sektorit publik për qëllime private dhe tregtare. Në këtë mënyrë, kuadri legjislativ i kompletuar dhe bashkëkohor i të drejtës për informim, e rendit Shqipërinë ndër vendet e para në botë që ofrojnë garancitë maksimale për ushtrimin e saj në praktikë.

Ligji nr. 78/2023 hyri në fuqi në nëntor të vitit 2023, dhe këto ndryshime pritet të sjellin akses më të lehtë të qytetarëve në informacionin/dokumentacionin me karakter publik. Ndër përmirësimet më të rëndësishme janë:

- përcaktimi i kompetencave të Komisionerit në këtë fushë;
- përcaktimi i përgjegjësisë së çdo nëpunësi/punonjësi të administratës, të cilët me veprimet apo mosveprimet e tyre nuk përmbushin detyrimet ligjore;
- detyrimi i autoritetit publik të zbatojë vendimin e Komisionerit kur ka urdhëruar dhënien e informacionit. Mos zbatimi i kësaj vendimmarjeje do të dënohet me sanksion administrativ, i cili do të aplikohet ndaj titullarit të institucionit;
- përcaktimi në mënyrë të qartë i detyrimit për publikimin e programit të transparencës në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik dhe detyrimi për reflektimin e datës së përditësimit të fundit;
- koordinatori për të drejtën e informimit përveç pagës mujore, përfiton edhe një shtesë për natyrë të veçantë pune;
- rishikimi i kufirit minimal të sanksioneve (gjobave), duke vendosur një raport më të drejtë dhe proporcional me të ardhurat në administratën publike.

Konferenca V Kombëtare *“E drejta për informim – Hapje, Transparencë, Digjitalizim”*, e cila kremtoi edhe 15-vjetorin e krijimit të institucionit, shërbeu si platformë për diskutimin dhe shkëmbimin e eksperiencave me fokus kuadrin e përmirësuar rregullator të fushës, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të autoriteteve publike, partnerëve ndërkombëtare, botës akademike, organizata të shoqërisë civile dhe medias. Përgjatë viteve të funksionimit të tij,

autoriteti ka arritur të jetë funksional dhe i pavarur në vendimmarrje, duke dhënë kontribut të denjë në fushat e përgjegjësisë.




E drejta për informim, si një nga të drejtat themelore të njeriut, vepron si parakusht për një qeverisje të hapur, që garanton transparencën dhe llogaridhënien e autoriteteve publike në një shoqëri demokratike. Prezantimi i situatës mbi përmbushjen e detyrimeve të legjislacionit të fushës, niveli i transparencës proaktive dhe aksesin në informacionin publik, ishin elementët kryesorë të agjendës së kësaj Konference. Ajo përfshiu gjithashtu edhe prezantimin e portalit qeveritar për të dhënat e hapura *opendata.gov.al*; si dhe risitë e Konventës 205 të KiE “Për aksesin në dokumente zyrtare”.

III.1 MONITORIMI I TRANSPARENCËS

Në kuadër të detyrave dhe kompetencave ligjore është vijuar me monitorimin e programeve të transparencës dhe përditësimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve në faqet zyrtare të internetit të autoriteteve publike. Kjo veprimtari përfshiu të gjitha kategoritë e tyre: institucione të pavarura, ato qendrore dhe të varësisë, të sistemit të drejtësisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, shoqëritë publike ku shteti zotëron shumicën e aksioneve, si dhe urdhrat profesionalë. Përgjatë 2023, ka pasur reduktim të numrit të autoriteteve publike krahasur me një vit më parë, ku kjo shifër është 332 AP, për shkak të ristrukturimit të një pjesë të tyre, veçanërisht, në sistemin e drejtësisë (gjykata dhe prokurori). Rezulton, se në të gjitha AP është caktuar koordinatori për të drejtën e informimit dhe të dhënat e tyre përditësohen edhe në portalin *pyetshtetin.al*; 305 autoritete publike kanë publikuar/përditësuar programin e transparencës dhe në 310 AP është funksional/përditësuar regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve.





Nga kryerja e monitorimit online, është vijuar edhe me zhvillimin e 33 inspektimeve në terren, kryesisht pranë institucioneve të varësisë të pushtetit qendror dhe institucioneve të pavarura, me objekt:

- përmbushjen e detyrimit për rishikimin e programit të transparencës, referuar nenit 5 të ligjit dhe Urdhrit nr. 187/2021;
- përmbushjen e detyrimit për plotësimin e kategorive të informacionit që bëhen publik pa kërkesë, referuar nenit 7 të ligjit;
- përmbushjen e detyrimit për krijimin, mbajtjen dhe bërjen publike të regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar nenit 8 të ligjit dhe Urdhrit nr. 188/2021.

Nisur nga inspektimet e kryera, si dhe gjendja e transparencës proaktive në momentin e monitorimit të faqeve zyrtare, autoriteteve publike ju prezantua situata me zbatimin e programit të transparencës dhe ju la një afat i dytë për adresimin e gjetjeve. Në përfundim të tij këto AP u rimonitoruan, ku u konstatua angazhim konkret dhe përmirësim i dukshëm i transparencës proaktive. Ndaj autoriteteve publike që nuk morën masa për përmbushjen e detyrimeve, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, u zhvilluan 24 seanca dëgjimore. Në përfundim të tyre dhe procesit të rimonitorimit, Komisioneri doli me 9 vendime urdhërimi për mosvënien në zbatim/mospërditësim të programit të transparencës, shoqëruar edhe me sanksion administrativ për personin përgjegjës.

Për konsolidimin e një mjedisi sa më të hapur e transparent për publikun, Zyra e Komisionerit miratoi Udhërrëfyesin për zbatimin e programit institucional të transparencës. Në këtë dokument përcaktohen rregulla të detajuara për informacionin që duhet të publikohet në faqen zyrtare të internetit të AP, në mënyrën sa më të thjeshtë e të plotë të mundshme për qytetarët.



■ Vetëdeklarimi i autoriteteve publike

Me hyrjen në fuqi të ndyshimeve të ligjit për të drejtën e informimit, një nga detyrimet e shtuara për autoritetet publike është raportimi çdo vit në lidhje me statistikat sipas tabelës së mëposhtme. Këto të dhëna shprehin në shifra veprimtarinë për periudhën janar-dhjetor 2023 të 304 nga 332 autoritetet publike që kanë vetëdeklaruar në janar të vitit 2024.

Nr. i AP	Nr. i kërkesave për informacion publik të regjistruar nga koordinatori	Nr. i kërkesave të dërguara për trajtim te koordinatori i një AP tjetër	Nr. i kërkesave që kanë marrë përgjigje të plotë	Nr. i kërkesave që kanë marrë përgjigje të pjesshme	Nr. i kërkesave jashtë objektivit të ligjit, por të trajtuar si detyrë funksionale nga AP	Nr. i kërkesave të pezulluara	Nr. i kërkesave të refuzuara
304	12323	1025	10831	583	2109	52	218

III.1.1 Transparenca proaktive në sektorin e arsimit

Nisur nga rëndësia që paraqet sistemi arsimor, Zyra e Komisionerit kishte në fokus të veprimtarisë së saj mbikëqyrëse, ndër të tjera, monitorimin e transparencës proaktive të autoriteteve publike në këtë sektor. Përveç parashikimeve të ligjit për të drejtën e informimit, transparenca e institucioneve të arsimit të lartë garantohet edhe nga legjislacioni i posaçëm, ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 781/2018 “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë”.

Për sa më sipër, u monitoruan 12 IAL publike dhe 6 autoritete të sistemit arsimor publik, për verifikimin e nivelit të zbatimit të programit të transparencës, ku në përfundim Komisioneri doli me 18 rekomandime. Nga rimonitorimi i faqeve zyrtare një pjesë e madhe e tyre përditësuan informacionin e munguar, ku në mënyrë të veçantë, për IAL ai përmbante të dhëna më të detajuara mbi:

- senatin akademik, rektorin dhe rektoratin;
- asamblenë e personelit akademik, komisionet e përhershme apo këshillin e etikës;
- bordin e administrimit, administratorin;
- qendrat kërkimore shkencore dhe Erasmus+;
- strukturat shëndetësore universitare;
- informacionin për kuotat e pranimit, bursat dhe tarifat e studimit.

Në këtë mënyrë, lehtësohet akoma edhe më shumë për studentët dhe gjithë të interesuarit marrja e informacionit të detajuar për shërbimet e ofruara nga IAL, duke ndikuar në uljen e numrit të kërkesave apo paraqitjen e tyre në sportelet fizike. Gjithsesi, me qëllim forcimin e kulturës së transparencës, në optikën e zhvillimeve teknologjike, kërkohet nga këto autoritete publike që të vijojnë pasqyrimin në programin e transparencës edhe të atyre kategorive/llojit të informacionit që nuk parashikohet në ligjin “Për të drejtën e informimit”. Një institucion i arsimit të lartë transparent dhe llogaridhënës kontribuon në përmirësimin e nivelit arsimor dhe shoqëror të të gjithë komunitetit.

III.2 Indekset e Transparencës Proaktive

Zyra e Komisionerit, për të katërtin vit radhazi, realizoi monitorimin vjetor të autoriteteve publike, duke hartuar 2 indekset e transparencës, për Institucionet Qendrore e të Varësisë dhe të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore, për matjen e nivelit të transparencës proaktive. Në ndryshim nga vitet e kaluara, në këto indekse janë përfshirë dhe monitoruar, sipas metodologjisë së përcaktuar, të gjitha autoritetet publike.

III.2.1 Indeksi i Transparencës Proaktive të Institucioneve Qendrore dhe të Varësisë

U verifikua niveli i transparencës proaktive për 242 institucione të kategorive: të pavarura, ato qendrore dhe të varësisë, të sistemit të drejtësisë, shoqëritë publike ku shteti zotëron shumicën e aksioneve, IAL, si dhe urdhrat profesionalë. Sistemi i matjes i përdorur në këtë monitorim i referohet 10 treguesve kryesorë, të cilët bëjnë vlerësimin e nivelit funksional të transparencës

proaktive. Numri total i pikëve të vlerësimit të treguesve është 10 (dhjetë), ku bazuar në treguesit e mëposhtëm, përlllogaritet shuma totale e vlerësimit për secilin institucion:

- publikimi i programit të transparencës;
- publikimi i strukturës së autoritetit publik;
- publikimi i funksioneve dhe detyrat e autoritetit publik;
- publikimi i cv të titullarit;
- publikimi i legjislacionit;
- të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- publikimi i raporteve të auditimit dhe monitorimit (psh raporte KLSH, ose raporte auditit të brendshme);
- publikimi i të dhënave për buxhetin për vitin financiar 2023;
- publikimi i regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik për vitin 2023;
- regjistri i kërkesave dhe pëgjigjeve i përditësuar gjatë vitit 2023.

Në përfundim të këtij monitorimi, vërejmë se 92 AP u klasifikuan me transparencë proaktive të lartë, 125 u klasifikuan me transparencë proaktive mesatare, 21 u klasifikuan me transparencë proaktive të ulët dhe 4 u klasifikuan me transparencë proaktive të pamjaftueshme. Duke analizuar shifrat me vitin parardhës, konstatohet rritje e numrit të AP të përfshira në grupin e parë me performancë të lartë, nga 12% në 38% në raport me totalin.


III.2.2 Indeksi i Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Në këtë monitorim u përfshinë 61 njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe 12 këshillat e qarqeve, ku për këta të fundit u përdorën indikatorët matës të transparencës proaktive të institucioneve qendrore. Ndërsa, për monitorimin e NJVV u zbatua sistemi i matjes së 10 treguesve kryesorë, si më poshtë:

- publikimi i programit të transparencës;
- publikimi i vendimeve të këshillit bashkiak;
- publikimi i cv së titullarit;
- publikimi i strukturës;
- publikimi i raporteve të auditimit dhe monitorimit;
- publikimi i PBA dhe regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike;
- të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- publikimi i legjislacionit;
- regjistri i kërkesave dhe pëgjigjeve i përditësuar gjatë vitit 2023;
- koordinatori për njoftimin dhe konsultimin me publikun.

Në përfundim të këtij monitorimi, rezultoi se 21 NJVV u klasifikuan me transparencë proaktive të lartë, 43 u klasifikuan me transparencë proaktive mesatare, 6 u klasifikuan me transparencë proaktive të ulët dhe 3 u klasifikuan me transparencë proaktive të pamjaftueshme.

▣ Njësi të Vetëqeverisjes Vendore



Vlerësojnë rritje të numrit të NJVV të përfshira në grupin e parë me transparencë proaktive të lartë, nga 21% gjatë 2022 në 29% për 2023, në raport me totalin, çka shënon dhe përmirësimin më të dukshëm të bërë nga monitorimet paraardhëse.

Të dy këto raporte gjenden të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Komisionerit dhe mund të konsultohen në lidhjen <https://idp.al/raporte-monitorimi-2023/>.

III.2 PROCESI MBIKËQYRËS

III.2.1 Trajtimi i ankesave

Zyra e Komisionerit administroi 956 ankesa për vitin 2023, si dhe vijoi me shqyrtimin administrativ të 48 procedurave të mbartura nga viti 2022 (gjithsej **1004** ankesa). Këto shifra tregojnë rënie të lehtë të numrit të ankesave për 2 vitet e fundit, çka reflekton tendencën e përmirësimit të transparencës proaktive të autoriteteve publike.

Në shifra nominale, ndaj NJVV u depozituan 291 ankesa dhe ndaj AP të tjera 665 ankesa. Rezulton se pesha specifike e ankesave për mosdhënie të informacionit vijon të anojë nga NJVV në raport me AP e tjera, edhe pse kjo përqindje është më e ulët krahasuar me 2022 dhe 2021.




Referuar të dhënave të administruara, për aq sa mund të indentifikohen, ankesat e paraqitura janë grupuar në katër kategori, sipas grafikut të mëposhtëm.

	2021	2022	2023
Gazetarë	409	456	395
Qytetar	322	343	367
OSHC	231	196	171
Avokatë	30	37	23


III.2.2 Vendimmarrja

Nga totali prej 1004 ankesash, për 609 prej tyre informacioni/dokumentacioni i kërkuar u është vënë në dispozicion ankuesve, gjatë zhvillimit të procesit të hetimit administrativ nga ana e Zyrës së Komisionerit. Gjithashtu, institucioni është shprehur me 45 vendime për 46 ankesa. Nga këto vendime, janë dhënë 41 vendime urdhërimi për dhënie informacioni, 3 vendime rrëzimi, dhe 1 vendim me sanksion administrativ.



Ndërkaq, 146 ankesa kanë rezultuar jashtë objektit të cilat rezultojnë për çështje me natyrë individuale, ose trajtohen nga ligje të tjera specifike. Kjo shifër përbën 14% të volumit të ankesave të paraqitura, në rënie krahasuar me vitin e kaluar, kur kjo kategori përbënte 20% të totalit. Zyra e Komisionerit konstaton përmirësim në lidhje me kuptueshmërinë e legjislacionit të kësaj fushe nga kërkuesit e informacionit - qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe media. Ky fakt duhet të nxisë akoma edhe më shumë shtimin e përpjekjeve/formave ndërgjegjësuese për qartësimin e ndryshimit mes një kërkese për informacion publik dhe asaj me karakter personal, kërkese për dhënie mendimi, apo për prononcim mediatik (intervistë).

Gjithashtu, rezultojnë 22 ankesa të refuzuara bazuar në kufizimet e ligjit, 59 ankesa janë paraqitur jashtë afatit, 36 ishin të paplota, si dhe 86 të tjera janë mbartur për shqyrtim në vitin 2024. Si pjesë e procesit të shqyrtimit administrativ për ankesat e depozituara, u zhvilluan 30 inspektime pranë autoriteteve publike dhe 45 seanca dëgjimore.



Qytetarët apo grupet e interesit e përqendruan kërkimin e informacionit/dokumentacionit për fondet e buxhetit të shtetit, partneritetet publike-private/koncensionet, prokurimet, mjedisin, trashëgiminë kulturore, planifikimin e territorit, ndihmën ekonomike, vendime të gjyqësorit, të dhëna statistikore mbi veprimtarinë e autoriteteve publike, etj. Ndër problematikat kryesore të verifikuara nga shqyrtimi i ankesave përmendim:


- i. paqartësi nga AP në lidhje me të drejtën e autorit të subjekteve të cilët marrin pjesë në një procedurë administrative. Këto raste nuk trajtohen në përputhje me parashikimet e nenit 17 apo legjislacionit specifik që rregullon të drejtën e autorit;
- ii. AP refuzojnë të vendosin në dispozicion informacionin e kërkuar, duke pretenduar për dëme të cilat mund t'i shkaktohen shtetit shqiptar nga palë të treta (procese që mund të atakohen në gjykatë/arbitrazh);
- iii. në kontratat publike vazhdojnë të parashikohen dispozita konfidencialiteti për informacionin/dokumentacionin që lidhet me to dhe në rast të mos zbatimit të tyre, parashikohen sanksione ndaj AP;
- iv. kërkuesit vijnë të përdorin dispozitat e ligjit përtej objektit dhe qëllimit të tij për çështje/praktika administrative me karakter individual, si: aksesin në të dhënat personale, dokumentacionin lidhur me lejet e ndërtimit, pronësia, procedurat e rekrutimit, etj;
- v. vijnë ankesat nga avokatët për akses në dokumentacionin e njehësuar, i cili shërben si provë në procese gjyqësore, duke anashkaluar në këtë mënyrë ligjin për avokatinë, apo Kodin e Procedurave Administrative;
- vi. vijnë kërkesat në formën e pyetjeve apo prononcime në media drejtuar autoriteteve publike/titullarëve në tejkalim të qëllimit të ligjit.

Si çdo vit, në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit dhe në portalin *pyetshtetin.al* publikohet lista e ankesave të administruara, në funksion të transparencës për publikun, e cila mund të konsultohet lehtësisht nga qytetarët apo grupet e interesit.

III.3 INSTRUMENTET ELEKTRONIKE

Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPDI), i ngritur sipas VKM nr. 145/2018, mundëson ushtrimin e së drejtës për informim me kërkesë dhe eventualisht të ankesës pranë Zyrës së Komisionerit. Kjo mënyrë siguron përfshirjen e drejtpërdrejtë të koordinatorit dhe garanton gjurmueshmërinë e procesit, duke mos lënë hapësira për abuzim dhe/ose shmangie të përmbushjes së detyrimeve ligjore.

Gjatë vitit 2023 u realizua instalimi i REKPDI në 27 autoritete të reja, duke e çuar në 222 numrin e AP, nga 195 që kjo shifër ishte në fund të 2022. Janë zhvilluar trajnime të rregullta me koordinatorët për mënyrën e përdorimit të tij. Ndërkohë, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me AKSHI ka vijuar punën për mirëmbajtjen e shërbimit të kërkesës për informacion dhe ankesës nëpërmjet portalit unik qeveritar *AMS/e-albania*. Ky sistem është funksional për 163 autoritete publike dhe i vjen në ndihmë qytetarëve, si një mënyrë alternative për të marrë informacion me karakter publik.



III.4 TË DHËNAT E HAPURA DHE RIPËRDORIMI I INFORMACIONIT, NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK

Informacioni i sektorit publik përbën një burim të jashtëzakonshëm të dhënash që mund të kontribuojë në përmirësimin e ekonomisë dhe të tregut të brendshëm. Përpunimi i mëtëjshëm i tyre mund të ketë një efekt transformues e të sjellë përfitime të rëndësishme për shoqërinë, veçanërisht, në krijimin e shërbimeve dhe hapjen e vendeve të punës të përshtatshme dhe me cilësi të lartë. Ligji nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” hyri në fuqi në muajin prill 2023, duke i ngarkuar Zyrës së Komisionerit kompetencën e promovimit, mbrojtjes dhe mbikëqyrjes së kësaj të drejte. Për këtë qëllim, në strukturën organike të institucionit funksionon një sektor i dedikuar. Autoriteti, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), është angazhuar në procesin e hartimit të akteve nënligjore. Paralelisht, ka vijuar puna për identifikimin e të dhënave të hapura që organet e

sektorit publik kanë në dokumentet ekzistues apo që i gjenerojnë rishtazi dhe publikimin e tyre sipas standardeve të kërkuara. Nga ana tjetër, Zyra e Komisionerit është e fokusuar në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit të AP, si një proces i rëndësishëm jo vetëm në aspektin teknik, por për vlerën e shtuar në ekonomi që do të sjellë zbatimin e këtij ligji.

Një kompetencë tjetër që i është ngarkuar autoritetit për mbikëqyrje është shqyrtimi i ankesave që burojnë nga ligji nr. 146/2014 *“Për njoftimin dhe konsultimin publik”*. Ky është një proces i cili mundëson pjesëmarrjen e qytetarëve që në fazën e hartimit të projektakteve me karakter kombëtar apo vendor, si dhe politikave me interes të lartë publik. Gjatë vitit 2023 nuk janë administruar ankesa nga palët e interesuara, por ka patur praktika administrative/komunikim shkresor me institucione apo grupe interesi.

IV. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Zyra e Komisionerit luan një rol kyç në konsolidimin e kulturës për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve, ku në kushtet e përparimit teknologjik, mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësisë së tyre është parësore dhe e domosdoshme. Në sferën publike ashtu edhe në atë private, po ndodhin ndryshime të rëndësishme në mënyrën se si individët ndërveprojnë apo socializohen, të ndikuar nga digjitalizimi i shërbimeve në një ekonomi gjithnjë e më globale.

Roli i Zyrës së Komisionerit shtrihet në tre drejtime: ndërgjegjësim, monitorim dhe mbikëqyrje, ku gjatë këtij viti është zhvilluar veprimtari intensive në fusha dhe sektorë të cilët përpunojnë kategori dhe sasi të mëdha të dhënash personale, me ndikim të lartë në privatësinë e individit. Bashkëpunimi në trekëndëshin *qytetar-kontrollues-autorit mbikëqyrës* është thelbësor që proceset përpunuese të zhvillohen me përgjegjshmëri dhe transparencë, në funksion të garantimit të kësaj të drejte. Proceset përpunuese të ndërlidhura me teknologjinë moderne nxjerrin në pah rëndësinë e aspektit të sigurisë së të dhënave personale, sidomos kur rreziku i sulmeve kibernetike është evident dhe kërcënues në përhapjen e paligjshme të tyre. Kjo situatë ka qënë, gjithashtu, një faktor që autoriteti të orientojë kontrolluesit në zbatimin e masave të duhura tekniko-administrative, sidomos në Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI).

Nga ana tjetër, ky aktivitet mbikëqyrës ushtrohet, gjithashtu, duke patur në fokus detyrimin e kontrolluesve për zbatimin e standardeve më bashkëkohore, si rezultat edhe i përafrimit së shpejti të legjislacionit kombëtar me atë evropian – GDPR dhe Direktivën e Policisë.

Po në këtë optikë, i është kushtuar rëndësi edhe konsolidimit të figurës së Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (DPO). Roli i tij është thelbësor brenda strukturës organizative të kontrolluesit/përpunuesit, në mënyrë që ky i fundit të zbatojë detyrimet ligjore dhe të garantojë të drejtat e subjektit të të dhënave personale/qytetarit. Kjo qasje e re është materializuar nëpërmjet krijimit të një rrjeti të posaçëm komunikimi mes Zyrës së Komisionerit dhe DPO të kontrolluesve të ndryshëm që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë. Aspekti teknik i kësaj marrëdhënie është funksionimi i Rregjistrimit të Nëpunësve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në të cilin në fund të vitit 2023 përmban të dhënat e 435 DPO, si të kontrolluesve publik ashtu edhe atyre privat, nga fusha e sektorë si: ai i telekomunikacionit, bankar e financiar, sigurimeve, shëndetësisë, arsimit, turizmit etj.


Mbetet e rëndësishme kuptueshmëria për rëndësinë e rolit të Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi, ndër të tjera, caktimi i tij do të përbëjë një nga detyrimet kryesore të legjislacionit të modernizuar të kësaj fushe, i cili vijon të jetë në proces. Në funksion të procesit të integritimit të vendit në BE dhe situatës konkrete ku kontrolluesit operojnë në përpunimin e të dhënave personale, vjen si domosdoshmëri finalizimi sa më parë i legjislacionit të ri. Zyra e Komisionerit vijon të nxisë të gjithë aktorët dhe faktorët e përfshirë në këtë proces që të përshpejtojnë procedurat për miratimin e tij.

IV.1 MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA

IV.1.1 Trajtimi i ankesave


Gjatë vitit 2023 u administruan 394 ankesa nga qytetarët, duke konfirmuar gjithnjë e më shumë kuptueshmërinë e subjekteve të të dhënave personale/qytetarëve për rëndësinë e mbrojtjes së kësaj të drejte themelore. Nga vlerësimi i objektit të ankesave, ndër tipologjitë kryesore përmendim:

- përhapjen e paligjshme të të dhënave personale;
- ushtrimin e të drejtës për akses për korrigjim/fshirje të të dhënave personale;
- marketingun e drejtpërdrejtë në lidhje me komunikimet e pakërkuara;
- ofrimin e shërbimeve nga zyrat noteriale.



IV.1.2 Hetimi administrativ

Zyra e Komisionerit realizoi 47 hetime administrative në kontrollues të ndryshëm, nga të cilat 32 me iniciativën e institucionit—*ex officio* dhe 15 hetime janë zhvilluar për verifikimin e ankesave të qytetarëve. 9 procedura hetimi administrativ janë kryer në kontrollues publik dhe 38 të tjera në kontrollues privat. Pjesë e këtij procesi është edhe zhvillimi i 37 seancave dëgjimore me palët e përfshira.



Sektorët kryesore ku u zhvilluan procedurat e hetimeve administrative janë:

- sektori financiar jo bankar;
- sektori i arsimit;
- sektori i administrimit dhe ndërmjetësimit të pasurive të paluajtëshme (real estate);
- sektori i shërbimeve postare;
- sektori i marketingut të drejtpërdrejtë;
- organet ligjzbatuese (në proces), ku përfshihet sistemi i prokurorisë - në funksion të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Eurojust; si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

IV.1.2.1 Hetime administrative në zbatim të Rezolutës së Kuvendit

Në zbatim të rezolutës së Kuvendit për vitin 2023 u zhvilluan hetime administrative:

- me objektin tematik zbatimi i masave tekniko-organizative për përpunimin e sigurt të të dhënave personale, veçanërisht, për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI).

Digjitalizimi i shërbimeve, automatikisht, ka rritur numrin e proceseve përpunuese nga kontrolluesit, si në sferën publike ashtu edhe në atë private të ekonomisë, duke zgjeruar, njëkohësisht, edhe kategoritë/llojin e të dhënave personale të përpunuara përmes sistemeve TIK. Kjo veprimtari mbikëqyrëse është bazuar në verifikimin e respektimit të parimeve dhe kriterëve ligjore për përpunimin e të dhënave personale, ku SMSI kanë si qëllim parandalimin e përhapjes së paligjshme të tyre.

Ky kompleks masash (SMSI) bazohet në identifikimin, analizimin dhe në zbutjen e rreziqeve ndaj sigurisë së të dhënave personale, duke marrë parasysh sistemet TIK për përpunimin e të dhënave, format manuale të përpunimit, sigurinë fizike të mjediseve, personelit dhe pajisjeve. Në mënyrë të posaçme, në standardet TIK duhet të garantohet:

- i. “konfidencialiteti” - që të dhënat personale të jenë të aksesueshme vetëm për personat e autorizuar;
- ii. “integriteti” - që të dhënat të jenë të sakta, të plota dhe duke ruajtur metodat e përpunimit të tyre;
- iii. “disponueshmëria” - që t’i krijohet akses përdoruesit të autorizuar në të dhënat dhe në sistemet e përpunimit;
- iv. “besueshmëria” - që çdo aktivitet/veprim mbi të dhënat të jetë i gjurmueshëm dhe i kontrollueshëm.

Gjithashtu, është e nevojshme që SMSI të përfshijë një set rregullash dhe dokumentesh detyruese për kontrolluesit, të tilla si Analizën e Ndikimit në të Dhënat Personale, Politikën e Sigurisë së Informacionit, Kontrollin e Sistemit të Arkivimit të të Dhënave, dhe të sigurojnë trajnim të vazhdueshëm të personelit. Me këtë objekt hetimet administrative u zhvilluan në:

- *sektorin financiar jo bankar*, 3 inspektime në kontrollues privat, në përfundim të të cilave Komisioneri doli me 1 Relacion dhe 2 Rekomandime;
- *sektorin e administrimit dhe ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme (real estate)*, 9 inspektime në kontrollues privat, në përfundim të të cilave Komisioneri doli me 4 Rekomandime dhe 2 Vendime.

Ndërsa përsa i përket rekomandimit tjetër të Rezolutës hetimet administrative u zhvilluan:

- *me objektin tematik mbi respektimin e disa detyrimeve ligjore, si: informimi dhe pëlqimi i qytetarëve, njoftimi në Regjistrin Elektronik të Kontrolluesve, masat e sigurisë, etj, si në kontrollues publik ashtu edhe në ata privat.*

Çdo kontrollues/përpunues është i detyruar të zbatojë parashikimet ligjore për garantimin e qytetarëve në një kontroll më të lartë mbi të dhënat e tyre personale. Kjo marrëdhënie është e rëndësishme për ushtrimin praktik të të drejtës së aksesit, për të kërkuar bllokimin, korrigjimin dhe fshirjen e të dhënave personale apo adresimin e ankesës pranë Zyrës së Komisionerit në rast të mos përbushjes së tyre. Në këtë drejtim hetimet administrative u zhvilluan në:

- *në sektorin e arsimit*, 13 inspektime kryesisht në kontrollues privat, në përfundim të të cilave Komisioneri doli me 2 Relacione, 1 Urdhër për fshirjen e të dhënave personale (fotografi/video të fëmijëve të publikuara në rrjetet sociale), 5 Rekomandime dhe 5 Vendime;
- *në sektorin e marketingut të drejtpërdrejtë*, 10 inspektime në kontrollues privat, në përfundim të të cilave Komisioneri doli me 5 Relacione, 1 Rekomandim dhe 4 Vendime;
- *në sektorin e shërbimit postar*, 7 inspektime (4 në kontrollues publik dhe 3 në kontrollues privat), në përfundim të të cilave Komisioneri doli me 2 Rekomandime dhe 2 Vendime.

Disa nga problematikat kryesore të konstatuara gjatë kësaj veprimtarie administrative janë:

- kontrolluesit nuk disponojnë rregullore specifike për përpunimin, mbledhjen, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale;
- specifikisht, kontrolluesit nuk disponojnë strategji ose plan për SMSI, që përfshin të gjithë komponentët e një sistemi të kompletuar për menaxhimin e sigurisë informacionit;
- kontrolluesit nuk informojnë qartësisht subjektet e të dhënave mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të tyre (përmes faqes zyrtare, apo formularëve të ndryshëm që aplikojnë, përdorimin e CCTV, etj.), personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë ata, apo afatin e mbajtjes së të dhënave;
- kontrolluesit nuk kanë marrë masat e duhura për të garantuar konfidencialitetin e të dhënave që përpunohen;
- kontrolluesit nuk kanë të parashikuar një afat konkret të ruajtjes së të dhënave personale;

- kontrolluesit nuk respektojnë detyrimin për njoftim dhe/ose përditësim pranë Zyrës së Komisionerit, sa herë që shtohen proceset përpunuese apo kategoritë e të dhënave personale;
- kontrolluesit nuk parashikojnë detyrime në përputhje me normat përkatëse ligjore në rastet e delegimit të proceseve përpunuese te palë të treta (në cilësinë e përpunuesit);
- kontrolluesit nuk i kushtojnë vëmendje domosdoshmërisë së trajnimit të vazhdueshëm të nëpunësve/punonjësve që kanë akses në të dhënat personale dhe mbikëqyrin proceset përpunuese.

Zyra e Komisionerit, vlerëson në tërësi, se nevojitet një angazhim më rigoroz i kontrolluesve në aspektin e thellimit të njohurive mbi legjislacionin e kësaj fushe, sidomos në kuadër të përafrimit të tij me atë evropian, në mënyrë që të garantohen plotësisht të drejtat e qytetarëve.

IV.1.2.2 Hetime administrative të tjera

Përveç sa më sipër, rëndësi i është kushtuar edhe mbikëqyrjes ligjore për kontrollues që administrojnë databaza të rëndësishme shtetërore, me përmbajtje të madhe të të dhënave personale. Hetimet administrative me objekt verifikimin e përpunimit, ruajtjes dhe sigurisë së të dhënave personale, u zhvilluan në kontrolluesit:

- a. Ministria e Financave dhe Ekonomisë për menaxhimin e sistemit AFMIS dhe bazave të tjera të të dhënave;
- b. Qendra e Shërbimeve Arsimore për menaxhimin e sistemit SMIP;
- c. si dhe kompania Aleat.

Ndër problematikat kryesore të konstatuara gjatë hetimeve administrative të realizuara pranë kontrolluesve të sipërcituar:

- aksesimi i databazës AFMIS nga përdorues administrativ nëpërmjet llogarive personale (qytetar) të krijuara për qëllimin e përfitimit të shërbimeve që ofrohen në portalin unik qeveritar *e-Albania*;
- MFE nuk ka marrë masa në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore, për përpunimin e të dhënave të përdoruesve gjatë autentifikimit në sistemin AFMIS;
- aksesimi i databazës SMIP nga përdorues administrativ nëpërmjet llogarive personale (qytetar) të krijuara për qëllimin e përfitimit të shërbimeve që ofrohen në portalin unik qeveritar *e-Albania*;
- QSHA është në pamundësi të demonstrojë kontrollin e plotë mbi të dhënat personale që përpunohen nëpërmjet SMIP, si dhe të përcaktojë kushtet e nevojshme tekniko-organizative për përmbushjen e detyrimeve nga përpunuesit;
- QSHA nuk ka marrë masa të përshtatshme, sa i përket ushtrimit të kompetencave në cilësinë e kontrolluesit, si dhe caktimit të detyrimeve në kontratën e shkruar me përpunuesit;
- kontrolluesi ALEAT nuk informon subjektet e të dhënave, lidhur me mjediset ku është vendosur sistemi i kamerave CCTV;

Në përfundim, Komisioneri doli me 3 Rekomandime për këta kontrollues.


IV.1.2.3 Hetime për monitorimin e zbatimit të vendimmarrjes të mëparshme

Në kuadër të verifikimit të zbatimit masave të lëna më herët në aktet vendimmarrëse të Komisionerit, u zhvilluan 9 hetime administrative në kontrollues privat. Në përfundim të këtij procesi, 4 prej tyre ju vendos sanksion administrativ për mos përmbushje të detyrimeve të lëna më herët, të tilla si: mungesa e bazës rregullatore për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, mos garantimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave/qytetarëve, mungesa e masave të përshtatshme tekniko-organizative për sigurinë e të dhënave. Ndërsa, për kontrolluesit e tjerë u konstatua përmbushja e detyrimeve në afatet e përcaktuara, çka është tregues pozitiv i ndërgjegjësimit për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve.


IV.1.3 Vendimmarrja

Në shifra përmbljedhëse, për vitin 2023 Komisionerit u shpreh me:

- ✓ 1 Urdhër;
- ✓ 21 Rekomandime;
- ✓ 19 Vendime, të cilat korrespondojnë me 64 sanksione administrative.



Qasja e Zyrës së Komisionerit, edhe nëpërmjet këtyre akteve, ka si qëllim parësor aspektin ndërgjegjësues për kontrolluesit/përpunuesit për mënyrën, format dhe qasjen për garantimin e kësaj të drejte dhe lirie themelore të individit. Zhvillimi teknologjik nxjerr akoma edhe më shumë në pah domosdoshmërinë e rritjes së investimeve, jo vetëm për përmirësimin e shërbimeve, por edhe për marrjen e masave për mbrojtjen e të dhënave në ofrimin e tyre.




IV.2 TRANSFERIMI NDËRKOMBËTAR

Zyra e Komisionerit trajtoi 12 praktika për autorizimin e transferimit në disa shtete pa nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, kryesisht nga sektori bankar. Në çdo rast, kontrolluesit janë orientuar mbi zbatimin e plotë të kuadrit rregullator për garantimin e përpunimit të drejtë dhe të ligjshëm të të dhënave personale të ndividëve, kur për to është kërkuar që ky proces të realizohet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Autoriteti, pas vlerësimit të kryer, ka konkluduar se këto praktika nuk kanë qënë në kushtet për t'u pajisur me autorizim për transferimin e të dhënave personale.

IV.3 REGJISTRI I NJOFTIMEVE

Në përmbushje të detyrimit ligjor kanë njoftuar për përpunimin e të dhënave personale 121 subjekte kontrolluese. Prej tyre, 81 u regjistruan për herë të parë dhe 40 të tjerët përditësuan/ndryshuan statusin e njoftimit të mëparshëm. Në total numri i subjekteve kontrolluese në Regjistrin e Njoftimeve të Kontrolluesve, në fund të vitit 2023, ishte 5956.



V. ROLI I ZYRËS SË KOMISIONERIT NË KONTEKSTIN E BRENDSHËM

Zyra e Komisionerit, në cilësinë e institucionit të pavarur që monitoron dhe mbikqyr zbatimin e legjislacionit që garanton zbatimin e dy të drejtave dhe lirive themelore, ka angazhim konstant dhe bashkëpunim të frutshëm me Kuvendin e Shqipërisë dhe institucionet e tjera të administratës publike/shtetërore. Ky ndërveprim është i rëndësishëm jo vetëm në konsolidimin e kulturës së komunikimit administrativ, por, veçanërisht, në arritjen e objektivave të autoritetit në të dy fushat kryesore të përgjegjësisë.

V.1 MARRËDHËNIET ME KUVENDIN E SHQIPËRISË

V.1.1 Zbatimi i Rezolutës

Procesi i raportimit vjetor në Kuvend përfundoi me miratimin e *“Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2022”*. Në këtë dokument, institucioni ligjvënës ka bërë vlerësime pozitive për arritjet e objektivave të Zyrës së Komisionerit, si dhe la rekomandimet përkatëse për vitin 2023.



Në rrafshin rregullator, Kuvendi ritheksoi domosdoshmërinë për përmbylljen e procedurave për miratimin e kuadrit ligjor sipas objektit të veprimtarisë së institucionit. Për fushën e të drejtës për informim, këto rekomandime synonin thellimin e mbikëqyrjes dhe monitorimit të zbatimit të ligjit, rritjen e transparencës proaktive të autoriteteve publike në verifikimin e zbatimit dhe përditësimit të Programit të Transparencës dhe Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, si dhe nxitjen e instalimit të Regjistrit Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit në sa më shumë autoritete publike dhe mundësimin e ndërthurjes së tij që ofrohen nga AMS/e-Albania.

Në lidhje me fushën e përgjegjësisë për mbrojtjen e të dhënave personale, Kuvendi rekomandoi monitorimin e përpunimit të ligjshëm të të dhënave nga kontrollues publik, me fokus, veprimtarinë e autoriteteve ligjzbatuese, si dhe në ata privat të sektorit financiar jobankar, ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme, apo monitorimin tematik të kontrolluesve të sektorëve të shërbimit postar, marketingut të drejtpërdrejtë dhe arsimit mbi zbatimin e disa detyrimeve ligjore (informim/pëlqim/njoftim/masat e sigurisë, etj).

Në aspektin e promovimit dhe ndërgjegjësimit rekomandimet kishin të bënin me zgjerimin e rrjetit të nëpunësve për mbrojtjen e të dhënave personale dhe forcimin e kapaciteteve profesionale për përmbushjen e detyrimeve ligjore, bashkëpunimin me qytetarë dhe grupe interesi për njohjen e kuadrit të modernizuar ligjor në të dyja fushat e veprimtarisë institucionale, si dhe nxitjen për zbatimin e tyre në praktikë.

Së fundi, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, Kuvendi rekomandoi vijimin e luajtjes së rolit aktiv në përmbushje të funksionit të anëtarit të Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit dhe në organizmat e tjerë ku Zyra është pjesë, si dhe marrja e masave përgatitore për realizimin me sukses të edicionit të 15-të të Konferencës së ICIC në Tiranë.

Të gjitha këto rekomandime dhe kërkesa janë realizuar plotësisht, progresi i përmbushjes së të cilave reflektohet në këtë Raport.

V.1.2 Roli i institucionit në veprimtarinë e Kuvendit

Zyra e Komisionerit ka patur angazhim të vazhdueshëm, aktiv dhe cilësor në trajtimin e çështjeve të cilat u shqyrtuan nga Kuvendi dhe lidhen me fushat e përgjegjësisë, për arritjen e standardeve bashkëkohore rregullatore në garantimin e të drejtave të qytetarëve.

Në kuadër të procesit të shqyrtimit të ndryshimeve/përmirësimeve të ligjit për të drejtën e informimit, institucioni mori pjesë në mbledhjet e Komisioneve për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, atë për Ekonominë dhe Financat, si dhe në atë për Sigurinë Kombëtare. Kuvendi miratoi në seancën plenare të datës 21 shtator 2023 ligjin nr. 78/2023 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”*.

Në takimet e Këshillit Kombëtar të Integritimit Evropian, Komisioneri ka patur rol aktiv në diskutimet e zhvilluara, për vetë rëndësinë që kanë fushat e përgjegjësisë institucionale në ecurinë e procesit të integritimit në BE.

Janë ndjekur dhe përmbushur të gjitha detyrimet e parashikuara në Vendimin e Kuvendit nr. 134/2018 përsa i përket raportimeve periodike mbi nivelin e zbatimit të Rezolutës, si dhe ecurinë e zbatimit të Vendimeve/Rekomandimeve të Komisionerit për kontrolluesit publikë.

V.2 PËRPUTHSHMËRIA E AKTEVE RREGULLATORE ME LEGJISLACIONIN PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Qasja konstante e Zyrës së Komisionerit për harmonizimin e kuadrit rregullator kombëtar me atë të mbrojtjes së të dhënave personale, nuk është vetëm një detyrim ligjor, por një praktikë e rëndësishme që ndikon në garantimin e kësaj të drejte themelore nga kontrolluesit (institucione/organe) publik. Gjatë vitit 2023, u dhanë mendime për 16 akte ligjore e nënligjore, si dhe 30 opinione për çështje/projekte të paraqitura nga kontrollues publik apo privat. Kjo veprimtari është udhëhequr nga fryma e zbatimit të standardeve të GDPR në legjislacionin shqiptar, ku parimet e përgjegjshmërisë, integritetit, konfidencialitetit apo i sigurisë së të dhënave kanë qënë fokus kryesor në këtë drejtim. Siç tregohet edhe në tabelën e mëposhtme, gjatë viteve të fundit shifrat flasin për ndërgjegjësimin në rritje të kontrolluesve publik për

përputhjen e legjislacionit specifik me atë të mbrojtjes së të dhënave personale, kur në objekt të tyre këto akte kanë edhe procese përpunuese.



Kjo veprimtari harmonizuese, mban parasysh domosdoshmërinë për arritjen e ekulibrit midis ndryshimeve/transformimeve shoqërore dhe inovacionit teknologjik në raport me respektimin e kësaj të drejte themelore të individit. Ndër projekt-aktet më kryesore për të cilat është dhënë mendim i konsultoni në lidhjen <https://idp.al/viti-2023-dhenie-mendimi-per-projekt-aktet/>.

VI. ROLI I ZYRËS SË KOMISIONERIT NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

Që prej krijimit të institucionit, angazhimi dhe roli i Zyrës së Komisionerit ka njohur rritje në kuadër të pjesëmarrjes, nismave e proceseve ndërkombëtare, si një dimension shumë i rëndësishëm i veprimtarisë së tij.

VI.1 PROCESI I INTEGRIMIT EVROPIAN

Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian është një objektivi strategjik kombëtar, ku Zyra e Komisionerit, si pjesë e Kapitullit “*Kriteri politik*”, Reforma në Administratën Publike, Kapitullit 23 “*Gjyqësori dhe të drejtat themelore*”, Funksionimi i Institucioneve Demokratike dhe Kapitullit 10 “*Shoqëria e informacionit dhe media*”, ka dhënë kontributin e saj në të gjitha fazat e procesit të hapjes së negociatave. Kjo ecuri përmbledh një tërësi aktivitete, raportimesh, bashkëpunimesh dhe takimesh, të cilat në përgjigje të sfidave të integrimit, synojnë të arrijnë brenda kornizave strategjike afat-mesme dhe afat-gjata, objektiva të cilat i shërbejnë zhvillimit të institucioneve demokratike, transparencës në vendimmarrjen e të gjitha niveleve, si dhe forcimit e shtetit të së drejtës.

VI.1.1 Procesi i vlerësimit analitik të përafrimit të legjislacionit me *acquis* të BE (Screening)

Procesi i vlerësimit analitik të përafrimit të legjislacionit me *acquis communautaire* përfundoi me publikimin në korrik 2023 të Raportit të Shqyrtimit të Komisionit Evropian (*Screening Report Albania*). Për fushat e përgjegjësive të Zyrës së Komisionerit në këtë dokument theksohet:

KAPITULLI “REFORMA NË ADMINISTRATËN PUBLIKE”

- “kuadri i ardhshëm legjislativ për aksesin në informacionin publik duhet të forcojë kompetencat e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale duke parashikuar mekanizma për zbatimin e vendimeve dhe mandatin për të kryer inspektime gjithëpërfshirëse. Po kështu, roli i koordinatorëve për të drejtën e informimit brenda autoriteteve publike duhet të forcohet”.

KAPITULLI 23 “GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE”

Seksioni “Të Drejtat Themelore” – Kuadri i Përgjithshëm

- “ka rëndësi të veçantë që të fuqizohet kapaciteti i organeve të pavarura të të drejtave të njeriut, duke përfshirë Avokatin e Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Seksioni “Për mbrojtjen e të dhënave personale”

- “Shqipëria ka nevojë të përafrojë ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e Përgjithshme të Bashkimit Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR) 2016/679 dhe me Direktivën e Policisë 2016/680;

- ligji duhet të sigurojë autonominë organizative të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe ta fuqizojë atë të miratojë vendime detyruese;
- për sa i përket zbatimin të ligjit, kapacitetet dhe kompetencat e Komisionerit, do të duhet të rriten nëse kërkohet që ai të përballojë me efikasitet përgjegjësitë e reja që rrjedhin nga ligji që pritet të miratohet;
- ndërgjegjësimi për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale, si një e drejtë themelore, është ende në nivele të ulëta ndër institucionet publike, si edhe në publikun e gjerë”.

VI.1.2 Udhërrëfyesit

Në përfundim të procesit *Screening*, si dhe pas analizës së akteve ligjore dhe kapaciteteve aktuale të institucioneve dhe aktorëve të përfshirë, u miratuan dokumentet politike dhe strategjike me masat kryesore që parashikohen të merren me qëllim adresimin e gjetjeve të Raportit të Shqyrtimit të KE për Shqipërinë:

- Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës - Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” (VKM nr. 736, datë 13.12.2023);
- Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike (VKM nr. 737, datë 13.12.2023).

Zyra e Komisionerit, bazuar në këto akte, ka parashikuar masa dhe aktivitete konkrete për përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Raporti i Shqyrtimit të KE për periudhën 2024-2030.

VI.1.3 Progres Raporti i Komisionit Evropian

Bashkimi Evropian vijon të theksojë domosdoshmërinë e miratimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale të përafuar, forcimin e pavarësisë dhe kompetencave të Komisionerit, si dhe rritjen e ndërgjegjësimin për garantimin e respektimit të kësaj të drejte themelore, veçanërisht, nga institucionet publike. Këto rekomandime janë adresuar, rradhazi, në dy Progres Raportet e BE për Shqipërinë për vitet 2022 dhe 2023, ku citohet:

2022

“Përmirësimi i mbrojtjes së të dhënave, në veçanti duke miratuar ligjin e rishikuar për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke forcuar Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke rritur ndërgjegjësimin, përfshirë institucionet publike.”

2023

“Të përmirësohet mbrojtja e të dhënave, në veçanti duke miratuar ligjin e rishikuar për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje të plotë me *acquis* të BE-së, duke forcuar pavarësinë dhe kapacitetet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe masat për rritjen e ndërgjegjësimin.”

Rekomandimet e mësipërme, për aq sa janë në tagër ligjor të institucionit, janë përmbushur nëpërmjet realizimit të masave të mëposhtme, por jo vetëm:

- *rol aktiv në finalizimin e procedurave të miratimit të projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i përafruar me GDPR dhe Direktivën e Policisë;*
- *kryerja e hetimeve sektoriale ex-officio për kontrolluesit publikë mbi zbatimin e detyrimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.*
- *zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere me kontrollues publik/privat nga fusha dhe sektorë të ndryshëm;*
- *monitorimin e zbatimit të akteve të lëna më herët nga Zyra e Komisionerit.*

VI.1.4 Raportime periodike në kuadër të procesit të integritit

Angazhimi teknik i institucionit në funksion të procesit të integritit në BE përfshin:

- pjesëmarrja aktive në Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për kapitujt e sipërpërmendur;
- pjesëmarrja në takimin dypalësh BE-Shqipëri për Kapitullin 10 “Shoqëria e informacionit dhe media”, ku u mbajt Prezantimi “Për kuadrin rregullator mbi të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”;
- përgatitja e informacionit mbi veprimtarinë e institucionit në kuadër të hartimit dhe dërgimit të kontributeve I, II dhe III të qeverisë shqiptare për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023;
- përgatitja e informacionit mbi veprimtarinë e institucionit në kuadër të zhvillimit të mbledhjes së Nënkomitetit të 14-të të BE “Drejtësia, Liria dhe Siguria”;
- përgatitja e informacionit mbi veprimtarinë e institucionit në kuadër të zhvillimit të mbledhjes së Nënkomitetit të Administratës Publike (PAR-Special Group);
- përgatitja e kontributit për Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026;
- përgatitja e kontributit për Programin Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian (PKABE) 2024-2030;
- përgatitja e informacionit në kuadër të Paketës së Semestrit të Integritit Evropian (PSIE) 2024;
- përgatitja e kontributit për pyetjet shitesë në kapitujt përkatës për raportin e ciklit të dytë të vlerësimit të Shqipërisë mbi zbatimin e Konventës “Kundër Korrupsionit të Kombeve të Bashkuara” (UNCAC);
- përgatitja e kontributit dhe informacionit për pyetjet shitesë në kuadër të gjetjeve paraprake të Raportit “Të Parashikimit të Konkurrueshmërisë 2024” (Competitiveness Outlook 2024) të OECD.

VI.2 MISIONI I VLERËSIMIT TË BE (*Peer Mission Review*)

Zyra e Komisionerit ishte një nga institucionet e pavaruara shqiptare të përzgjedhura për auditim në kuadër të Misionit të Vlerësimit të BE (*Peer Mission Review*). Qëllimi i tij ishte identifikimi i kapaciteteve administrative, veçanërisht, rregullimin ligjor të statusit, autonomisë financiare, rekrutimin e stafit apo procesin e vendimmarrjes; marrëdhëniet me pushtetin ligjvënës dhe atë ekzekutiv; si dhe perceptimin e besimit të publikut për pavarësinë institucionale. Në përfundim të këtij procesi, Misioni i Vlerësimit hartoi Raportin ndër gjetjet kryesore të të cilit citojmë:

“Kuari ligjor siguron në mënyrë adekuate funksionimin e pavarur të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me përjashtim të autonomisë organizative (autonomia për të krijuar në mënyrë të pavarur strukturën organizative). Kuadri legjislativ gjithashtu krijon terren të mjaftueshëm për mbrojtjen e të dyja të drejtave. Megjithatë, ka probleme në praktikë për zbatimin efektiv të rekomandimeve.”

Në vijim të sa më sipër, ekspertët e BE kanë nënvizuar se:

“Sipas nenit 37 Ligjit 9887/2008, Kuvendi përcakton strukturën organizative të Komisionerit. Një zgjidhje e tillë është në kundërshtim me standardin ndërkombëtar sepse pengon autonominë e Komisionerit.”

Raporti përmban vlerësime pozitive përse i përket kryerjes së detyrave në mënyrë profesionale si nga vetë Komisioneri ashtu edhe nga stafi, e gjithashtu, mbi reputacionin e lartë në publik dhe midis institucioneve të tjera. Por nga ana tjetër, është theksuar se:

“Përse i përket kapaciteteve të Komisionerit, numri aktual i stafit nuk mjafton për të menaxhuar ngarkesën e punës dhe përforcimi i stafit do të jetë i nevojshëm me ndryshimet e ardhshme ligjore. Duke qenë se kryerja e duhur e detyrave në fushën e mbrojtjes së të dhënave kërkon njohuri të specializuara ligjore dhe teknologjike, dhe se pagesa për profile të tilla nuk është konkurruese në sektorin publik, Komisionerit duhet t’i jepet liria për të shpërblyer siç duhet stafin e tij profesional”.

Ky Raport në tërësinë e tij, edhe një herë, sjell në vëmendje rolin thelbësor që ka Zyra e Komisionerit në arkitekturën institucionale shqiptare, e mandatuar për mbikëqyrjen ligjore për garantimin e këtyre dy të drejtave themelore.

VI.3 PJESËMARRJA NË FORUME DHE RRJETE NDËRKOMBËTARE

VI.3.1 Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit (ICIC)

“Ndërveprimi mes shteteve: Roli global i të drejtës për informim për konsolidimin e demokracisë, gjithëpërfshirjen dhe zhvillimin” ishte tema qëndrore e edicionit të 14-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC). Si takimi kryesor vjetor që mbledh komunitetin e profesionistëve të kësaj fushe, në fokus të tij ishte forcimi i transparencës dhe integritetit të autoriteteve publike. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga mbi 85 autoritete anëtare/vëzhguese të organizatës nga të gjitha kontinentet, por edhe nga organizma partnere, bota akademike, shoqëria civile, media, etj.

- Zyra e Komisionerit është përzgjedhur si organizatore e edicionit të 15-të të këtij forumi, në vitin 2024. Komisioneri, z. Besnik Dervishi, mbajti një fjalë përshëndetëse ku tha se zhvillimi i kësaj Konference për herë të parë në Tiranë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor është shumë i rëndësishëm. *“Ne udhëhiqemi nga vizioni i përbashkët për promovimin e ushtrimit të të drejtës për informim dhe transparencës në një mjedis gjithnjë e më shumë të ndërlidhur. Besojmë se këto vlera janë thelbësore për zhvillimin e shoqërive demokratike”*.

Në punimet e Sesionit të Mbyllur të ICIC u raportua rreth veprimtarisë së vitit paraardhës dhe u miratua Raporti Vjetor; si dhe u realizuan raportimet respektive të Grupeve të Punës apo Rajonale mbi zhvillimet në këtë fushë. Zyra e Komisionerit është anëtare në dy nga Grupet e Punës, atë për *“Promovimin e transparencës proaktive”* dhe mbi *“Trajnimet”*. Anëtarësia e Konferencës miratoi ndryshimet e propozuara në Kartën e Johaneshburgut, u zhvilluan zgjedhjet për anëtarët e rinj të Komitetit Ekzekutiv për periudhën 2023-2026, si dhe u diskutua në lidhje me ecurinë e bashkëpunimit strategjik ICIC-UNESCO.

Përgjatë punimeve të Sesionit të Hapur pjesëmarrësit diskutuan për çështje të rëndësishme, si: forcimi i rolit dhe veprimtarisë së institucioneve mbikëqyrëse, aksesit në informacion si një përgjigje ndaj sfidave moderne të demokracisë, apo mbi rolin e kësaj të drejte në nxitjen e zhvillimit ekonomik-shoqëror. Gjithashtu, tema të tjera me interes ishin: prokurimet publike transparente që ndikojnë në efektivitetin e kostove për ekonominë; keqinformimi, rreziqet dhe përdorimi i inteligjencës artificiale; si dhe krahasimi i modeleve të ndryshme rregullatore dhe nevoja për përmirësimin/forcimin e standardeve ligjore.

VI.3.2 Asambleja Globale e Privatësisë (GPA)

Me moton *“Valë, Dallgë, Rryma”* u zhvilluan punimet e edicionit të 45-të të Asamblesë Globale të Privatësisë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga 169 autoritete anëtare/vëzhguese. Gjatë punimeve të Sesionit të Mbyllur u miratuan këto dokumente, të cilat do të nxisin forcimin e bazës rregullatore në këtë fushë:

- ✓ Rezoluta mbi inteligjencën artificiale në çështjet e punësimit;
- ✓ Rezoluta për sistemet gjeneruese të inteligjencës artificiale;
- ✓ Rezoluta për arritjen e standardeve globale në mbrojtjen e të dhënave personale;
- ✓ Rezoluta për të dhënat personale shëndetësore;
- ✓ Rezoluta për mbrojtjen e të dhënave personale me perspektivë gjinore;
- ✓ Rezoluta për ngritjen e bibliotekës së GPA;
- ✓ Rezoluta për “Çmimin për të drejtat e njeriut dhe privatësinë”.

Punimet e këtij Sesionit u përqëndruan edhe në diskutimin e ndikimit të teknologjisë dhe digjitalizimit në përpunimin e të dhënave personale; përmirësimin e qeverisjes dhe garantimin e të drejtave nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja apo dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar nëpërmjet shkëmbimit të praktikave më të mira. Anëtarësia e GPA diskutoi dhe miratoi raportet vjetore të Grupeve respektive të Punës të organizatës, si dhe u pranuan me të drejta të plota apo me statusin e vëzhguesit 11 autoritete/organizma të tjera.

Në Sesionin e Hapur diskutimet u përqëndruan në 9 panele të ndryshme, ku u trajtuan tema me shumë interes për komunitetin e profesionistëve të privatësisë dhe më gjerë. Me pjesëmarrjen

edhe të përfaqësuesve të botës akademike, shoqërisë civile, biznesit, medias etj, u fol për strategjitë e politikave për teknologjinë; problematikat e përdorimit të inteligjencës artificiale në optikën e kuadrit rregullator; nxitjen e ndërveprimit të autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave me institucionet rregullatore të fushave të tjera, apo mbi raportin mes shërbimeve financiare dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Tema të tjera ishin edhe ato në lidhje me vlerësimin e risqeve në këtë fushë; mekanizmat e transferimit ndërkombëtar të të dhënave dhe domosdoshmëria e bashkëpunimit; si dhe nevoja për më shumë veprim nga autoritetet në funksion të garantimit të standardeve më të larta për mbrojtjen e të dhënave personale.

VI.3.3 Bashkëpunimi me Eurojust

Zyra e Komisionerit, në përmbushje të “Marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST”, të ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr. 113/2018, ka rol të rëndësishëm në monitorimin e zbatimit të detyrimeve në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale gjatë veprimtarisë së strukturave të prokurorisë shqiptare. Kjo Marrëveshje ka përcaktuar shkëmbimin e rregullt të pikëpamjeve, mes Zyrës së Komisionerit dhe EUROJUST në lidhje me zbatimin e saj dhe zhvillimet e mëtejshme në këtë fushë dhe sigurisë së të dhënave personale. Për këtë qëllim, Oficeri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i EUROJUST dhe autoriteti shqiptar i raportojnë njëri-tjetrit të paktën një herë në vit.

Për arritjen e këtij e objekti, stafi i Zyrës së Komisionerit, së bashku me përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme, morën pjesë në vizitën studimore të organizuar në selinë e EUROJUST, me mbështetjen e instrumentit të BE TAIEX. Në këtë aktivitet u shkëmbyen eksperiencat dhe praktikat më të mira edhe me Autoritetin homolog të Mbretërisë së Vendeve të Ulta. Produkt i kësaj vizite studimore është përvoja e fituar për hartimin e Raportit Vjetor në zbatim të kësaj Marrëveshjeje.

VI.3.4 Bashkëpunimi Rajonal

- Në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Agjencisë për Informim dhe Privatësi të Kosovës (AIP), gjatë vitit 2023 u zhvillua takimi i dytë me pjesëmarrjen e stafeve përkatës, që kishte për qëllim forcimin e bashkëpunimit profesional, shkëmbimin/diskutimin e rasteve nga praktika administrative, si dhe planifikimin e nismave për të ardhmen. Aktiviteti u mbajt përgjatë dy ditëve, ku sipas agjendës u prezantua kuadri rregullator dhe veprimtaria e AIP, si dhe u trajtuan detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave përbërëse të autoritetit të Kosovës. Në këtë këndvështrim, Zyra e Komisionerit u angazhua në ofrimin e asistencës për zbatimin e kuadrit rregullator në fushën e të drejtës për informim, kryesisht, për hartimin/përditësimin e Programit të Transparencës, duke marrë në konsideratë përvojën e akumuluar në këtë drejtim në Shqipëri. Nga ana tjetër, nga shqyrtimi i rasteve praktike për fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, u ra dakord që të intensifikohet bashkëpunimi, edhe në kontekstin e zhvillimit të hetimeve të përbashkëta. Gjatë takimit u vlerësua kontributi i Zyrës së Komisionerit për anëtarësimin e AIP në Konferencën Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC). Njëkohësisht, u diskutua për harmonizimin e përpjekjeve për

njohjen sa më të gjerë të autoritetit të Kosovës në kuadër të organizmave ndërkombëtare në të dy këto fusha.

- Me iniciativën e degës në Maqedoninë e Veriut të Agjencisë Gjermane për Zhvillim (GIZ), u zhvillua në Shkup një takim mbi mbrojtjen e të dhënave personale në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Të pranishëm në të ishin zyrtarë të lartë të autoriteteve nga Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Bosnjë-Hercegovina dhe Serbia, të cilët shkëmbyen përvojë me dy ekspertë nga Agjencia Kroate për Mbrojtjen e të Dhënave. Diskutimet u fokusuan te procesi i vazhdueshëm i digjitalizimit të shërbimeve publike apo edhe atyre që ofrohen nga sfera private e biznesit në raport me respektimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale. Një çështje tjetër me rëndësi që u trajtua në takim ishte raporti i GDPR me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe procesi i përafritimit të tij në legjislacionin e brendshëm të secilit shtet, vlerësimi i ndikimit në privatësi dhe sidomos, aspekte të sigurisë për të dhënat e ndjeshme. Njëkohësisht, përfaqësuesit e autoriteteve patën mundësinë të vlerësojnë edhe nevojat për zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve institucionale në këtë fushë dhe të bashkëveprojnë për hartimin e një strategjie bashkëpunimi rajonal për mbrojtjen e të dhënave.

VI.3.5 Pjesëmarrje në forume të tjera

- Me temë “E drejta për informim për dokumentet zyrtare, standardet e Këshillit të Evropës, u mbajt në Poloni takimi për shkëmbimin e praktikave të mira në këtë fushë. Zyra e Komisionerit mori pjesë në këtë aktivitet si përfaqësuese e Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit dhe Komitetit të saj Ekzekutiv, për të prezantuar përvojën në zbatimin e standardeve të Konventës “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, e njohur ndryshe si Konventa e Tromsøs (205) e KiE. Një çështje tjetër me rëndësi që u diskutua në aktivitet ishte dhe veprimtaria në kuadër të bashkëpunimit dy dhe shumë-palësh për nxitjen e adoptimit të këtyre standardeve bashkëkohore jo vetëm në hapësirën gjeografike të Këshillit të Evropës, por edhe më gjerë. Ky aktivitet u mbajt në kuadër të Konferencës për të Drejtat e Njeriut të Varshavës 2023 të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).
- Zyra e Komisionerit mori pjesë në Takimin e 2-të të Punës të Rasteve të Veçanta (Case Handling Workshop-CHW), organizuar nga Autoriteti homolog i Gjermanisë. Në fokus të diskutimeve e shkëmbimit të eksperiencave ishte krahasimi i modeleve të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe i funksionimit të institucioneve mbikëqyrëse. Përfaqësuesit e Zyrës paraqitën dy prezantime mbi “*Transparencën proaktive efektive të Autoriteteve Publike*” dhe “*Informacionin publik në çështjet gjyqësore*”.

Zyra e Komisionerit, në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare, ka marrë pjesë rregullisht në aktivitete, takime, trajnime apo seminare të organizuara nga:

- ✓ Komiteti Ekzekutiv i ICIC;
- ✓ Komiteti Konsultativ i Konventës 108 të Këshillit të Evropës (T-PD);
- ✓ Komiteti Konsultativ i Konventës 205 të Këshillit të Evropës;
- ✓ Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave (EDPB);

- ✓ Konferenca Evropiane e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (ECDPA);
- ✓ Grupet Ndërkombëtare të Punës të ICIC-së “Transparency by design” dhe “Training”;
- ✓ Konferencën me rastin e 28 Shtatorit – Ditës Ndërkombëtare për të Drejtën e Informimit e organizuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO) dhe Universiteti i Oksfordit në Britani;
- ✓ Seminari i Shqyrtimit të Rasteve Praktike (Case Handling Workshop) të Konferencës Evropiane të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale;
- ✓ Grupi Ndërkombëtar i Punës për Mbrojtjen e të Dhënave në Teknologji (Grupi i Berlinit).

VII. NDËRGJEGJËSIMI DHE PROMOVIMI I TË DREJTAVE

Mjedisi teknologjik dhe digjitalizimi gjithnjë e kompleks i shërbimeve, ka nxitur natyrshëm aspektin ndërgjegjësues dhe promovues në veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit, duke theksuar edukimin dhe komunikimin proaktiv me qytetarët apo grupet e interesit. Ky aktivitet ka synuar të forcojë njohuritë mbi ushtrimin praktik të të drejtave, paralelisht, duke orientuar në zbatimin e standardeve bashkëkohore që ofron legjislacioni i modernizuar në të dy fushat e përgjegjësisë institucionale.

VII.1. DITËT NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE

▪ 28 Janar – Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale

Në kuadër të kremtimit të kësaj Dite, nismës së Zyrës së Komisionerit iu bashkuan subjekte mediatike publike e private në transmetimin e videos të përgatitur me këtë rast, e cila përmban mesazhe ndërgjegjësuese për publikun për mbrojtjen e të dhënave personale. Njëkohësisht, kontrollues publik, institucione qendrore e të varësisë, të pavarura apo të vetëqeverisjes vendore, publikuan në faqet e tyre zyrtare të internetit posterin elektronik promovues për ushtrimin e kësaj të drejte themelore në praktikë. Duke patur në vëmendje përdorimin e sigurt të internetit, në platformat/rjetet sociale të Zyrës së Komisionerit u publikua edhe posterit me fokus ndërgjegjësimin e brezit të ri.



Gjithashtu, në bashkëpunim me Kolegjin Universitar të Biznesit u mbajt leksioni i hapur me pjesëmarrjen e studentëve dhe staf akademik e administrativ të tij. Të pranishmit u njohën me kuadrin ligjor të fushës, të drejtat e qytetarëve dhe detyrimet e kontrolluesve/përpunuesve, si dhe me sfidat kryesore në këtë fushë. Nëpërmjet shembujve konkretë, u ofruan këshilla praktike lidhur me sjelljen e individit në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale, duke theksuar përgjegjshmërinë në proceset përpunuese si një nga elementët e rëndësishëm në rritjen e cilësisë së shërbimeve, sigurinë dhe transparencën e tyre.

▪ 28 Shtator - Dita e të Drejtës për Informim

Në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, si një nga autoritetet publike që mban një peshë specifike shumë të madhe në dhënie të informacionit, po ashtu edhe në përcaktimin e standardeve të shërbimit për qytetarët, u zhvillua aktiviteti ndërgjegjësues për këtë Ditë. Për Zyrën e Komisionerit, ky institucion është një partner korrekt dhe i përkushtuar në zbatimin e

legjislacionit të fushës. Gjatë takimit, vëmendja u përqendrua në përmirësimet e ligjit për të drejtën e informimit, transparencën proaktive dhe konsolidimin e rolit të koordinatorit. Aktiviteti shërbeu për rritjen e ndërgjegjësimit të nëpunësve/punonjësve në ushtrimin e funksioneve të tyre me profesionalizëm, për forcimin e transparencës, përgjegjshmërisë, llogaridhënies dhe mirëqeverisjes.

Dita e të Drejtës për Informim, ndërkombëtarisht emërtuar “Dita e Aksesit Universal në Informacion - International Day of Universal Access to Information” (IDUAI), prej vitit 2019 është njohur zyrtarisht edhe nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

VII.2 AKTIVITETE NDËRGJEGJËSUESE

Njohja e qytetarëve apo grupeve të interesit me kuadrin rregullator të fushave të përgjegjësive përbën një nga komponentët kryesorë të veprimtarisë institucionale, si përmbushje e objektivit për nxitjen e kulturës së respektimit të të drejtave themelore dhe ushtrimit të tyre në praktikë.


- Në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare për Zhvillim të Qëndrueshëm (ASDO), me mbështetjen e Ambasadës Zvicerane në Tiranë, u zbatua projekti “Siguria kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave”. Në kuadër të tij u mbajtën tryeza të rumbullakta me përfaqësues të sektorit bankar e financiar, shëndetësisë, arsimit, pasurive të paluajtshme, medias dhe shoqërisë civile. Qëllimi i projektit ishte njohja me reformën e madhe rregullatore në BE në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe sfidat në zbatimin e legjislacionit shqiptar të përafuar me atë komunitar. Përzgjedhja e këtyre sektorëve u ndikua nga volumi, sasia dhe lloji i madh i të dhënave personale të qytetarëve, përfshi edhe ato sensitive, që ata përpunojnë. Kjo veprimtari e kombinuar me zhvillimin teknologjik, nxjerr në fokus aspektin e forcimit të sigurisë, në optikën e një mjedisi gjithnjë e më të rrezikuar nga sulmet kibernetike. Në lidhje me veprimtarinë e tyre specifike, u trajtuan raste nga praktika, duke orientuar qasjen e domosdoshme rregullatore dhe teknike për garantimin e të drejtave të qytetarëve. Në takimin përmbyllës të projektit, u theksua se ai ishte një nga përvojat më të mira që Zyra e Komisionerit ka patur ndër vite, pikërisht për rëndësinë që ka përdorimi i sigurt dhe me standardet më të larta i të dhënave personale nga kontrolluesit publikë dhe ata privatë. Produkt i projektit është platforma *inso.al*, e cila ka si qëllim edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi sigurinë kibernetike, mbrojtjen e të dhënave apo dhe mundësinë e ofrimit të trajnimeve për profesionistët e këtyre fushave.
- Në kuadër të bashkëpunimit me Prezencën në Shqipëri të OSBE, u zhvilluan në bashkitë Malësi e Madhe, Gjirokastër dhe Kavajë, aktivitetet trajnuese për zbatimin e detyrimeve të legjislacionit të të drejtës për informim dhe atij për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo nismë përfshinte 3 elementë: ndërgjegjësimin e qytetarëve, takime me përfaqësues të institucioneve që ushtrojnë veprimtarinë në këto bashki, mbi veprimtarinë monitoruese e mbikëqyrëse të autoritetit, si dhe shkëmbimin e praktikave më të mira në kuadër të transparencës dhe përgjegjshmërisë me publikun. Një vëmendje e posaçme në këto aktivitete ju kushtua modernizimit dhe risive të legjislacionit.
- Zyra e Komisionerit zhvilloi aktivitetin për prezantimin e Udhëzuesit “Për përpunimin e të dhënave personale në kontekstin e fushatave zgjedhore”, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të autoriteteve të pavaruara, organizatave të shoqërisë civile dhe medias. Ky dokument synon orientimin e subjekteve politike në garantimin e mbrojtjen e të

dhënave personale të votuesve gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Zyra e Komisionerit bashkëpunoi me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që ky Udhëzues të përfshihej në setin e dokumenteve zgjedhore për strukturat dhe aktorët e përfshirë në këtë proces.

- Në kuadër të “Javës së integritetit”, Zyra e Komisionerit dhe Ministria e Drejtësisë, organizuan forumin e diskutimit në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Në këtë aktivitet morën pjesë ekspertë të politikave antikorrupsion, të së drejtës për informim, si edhe studentë e staf akademik. Njëkohësisht, në takim ishin edhe përfaqësues nga Zyra Rajonale për Evropën Juglindore e UNODC (struktura kundër drogës dhe krimi), e cila jep një kontribut në mbështetjen e zbatimit të Konventës së OKB kundër korrupsionit në vendin tonë. Të pranishmit u njohën me rolin dhe funksionet e koordinatorit kombëtar kundër korrupsionit, si dhe me kuadrin ligjor që garanton transparencën e autoriteteve publike dhe ushtrimin e të drejtës për informim nga qytetarët. Po ashtu edhe përfaqësuesit e Zyrës së UNODC prezantuan veprimtarinë e tyre për sa i përket luftës kundër korrupsionit në rajonin e Evropës Juglindore.
- Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka nisur gjatë vitit 2023, të zbatojë projektin “Transparenca proaktive e institucioneve të pavarura”. Takimi i parë u zhvillua pranë Entin Rregullator të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujrave të Ndotura (ERRU). Kjo iniciativë ka për qëllim që nëpërmjet komunikimit të hapur dhe të drejtpërdrejtë të nxisë përmirësimin e instrumentit të Programit të Transparencës të këtyre autoriteteve publike, përgjegjshmërinë në funksionimin e tyre dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje. Ky projekt do të shtrihet dhe në vitet në vijim në autoritetet e tjera të pavarura.
- Zyra e Komisionerit mori pjesë në Panairin Festa e Inovacionit 2023 (Innovation Fest), me dy prezantime me temë “*Sigurimi i suksesit në tregtinë elektronike: lundrimi në sfidat e sigurisë kibernetike dhe privatësisë së të dhënave për rritje të qëndrueshme*” dhe “*Lidhja me njëri-tjetrin përmes diasporës. Privatësia e të dhënave – një faktor i rëndësishëm për tregtinë elektronike*”. Në to u trajtua legjislacioni në fuqi i mbrojtjes së të dhënave personale, funksionet e institucionit, si dhe aspekte që lidhen me përpunimin e të dhënave personale gjatë ofrimit të shërbimeve nga sektori TIK. Po ashtu, autoriteti u përfaqësua përgjatë ditëve të zhvillimit të “InnFest 2023” me një stendë të posaçme me materiale/botime ndërgjegjësuese.
- Zyra e Komisionerit mori pjesë në edicionin e rradhës të “Panairit Ndërkombëtar të Tiranës”. Ky aktivitet shërbeu si një platformë informimi, komunikimi dhe nxitje e bashkëpunimit mes qytetarëve, institucioneve publike/shtetërore dhe komunitetit të biznesit, për ofrimin e shërbimeve inovatore dhe zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të vendit. Si pjesë e agjendës së Panairit, Zyra e Komisionerit zhvilloi aktivitetin me temë “Siguria e të dhënave personale në Shqipëri dhe sfidat e digjitalizimit”. Në fokus ishte informimi dhe njohja me kuadrin rregullator në këtë fushë, ecuria e procesit të përafrimit me GDPR të legjislacionit kombëtar, si dhe roli mbikëqyrës i autoritetit. Të ndërthurur me shembuj nga praktika, prezantimet trajtuan ndërveprimin mes zbatimit të standardeve bashkëkohore me sfidat e transformimit teknologjik/digjital në ofrimin e shërbimeve me cilësi dhe përgjegjshmëri, si në sferën publike ashtu edhe në atë private. Edhe në këtë aktivitet, institucioni kishte stendën e tij përfaqësuese.
- Gjatë vitit 2023, u publikuan numrat 15 dhe 16 të Revistës “Informim dhe Privatësi”, respektivisht, për 6-mujorin I dhe II.

- Zyra e Komisionerit publikoi në faqen zyrtare të internetit 12 newsletters “E drejta për informim”, përmbledhje njohëse mujore mbi veprimtarinë, mbikëqyrjen për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit.

Institucioni i kushton një vëmendje të veçantë mbështetjes së personave me aftësi ndryshe, pavarësisht nga problematika që ata hasin, në kuadër të rritjes së përgjegjesisë sociale.



Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë dhe Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë, u krijua faqja zyrtare e internetit të Zyrës së Komisionerit që mundëson jo vetëm aspektin ndërgjegjësues, por edhe aksesin e domosdoshëm teknik në informacion/dokumentacion për të dy fushat e përgjegjesisë për këto kategori qytetarësh. Në këtë mënyrë, institucioni është nga të parët në vend që zbaton këtë qasje dhe standarde.

VII.3 BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE

- Në cilësinë e partnerit në shërbim të interesit publik, bashkëpunimi me shoqërinë civile është thelbësor në shkëmbimin e përvojave në funksion të forcimit të shtetit të së drejtës dhe shoqërisë demokratike. Në vijim të traditës disavjeçare, Komisioneri ftoi në një takim përfaqësues të OjF dhe medias investigative, për të diskutuar dhe bërë një bilanc të veprimtarisë në fushën e të drejtës për informim përgjatë vitit 2023. Risitë e legjislacionit të përmirësuar, të konsultuara gjerësisht me shoqërinë civile, organizatat e medias investigative dhe grupet e interesit, ishin në fokus të takimit. Po ashtu, u fol mbi kontributin e tyre aktiv në konsolidimin e kulturës së përgjegjshmërisë e të transparencës së autoriteteve publike. Të pranishmit vlerësuan punën dhe qasjen e Zyrës dhe trajtuan çështje e problematika konkrete që janë të ndjeshme në veprimtarinë e tyre. Nga ana tjetër, u diskutua për shfrytëzimin e të gjitha mundësive për përmbushjen e detyrimeve ligjore nga autoritetet publike.
- Zyra e Komisionerit bashkëpunoi me organizatat dhe mediat investigative “Qendrën për Ekselencë Destiny”, “Together for Life”, “Balkan Investigative Reporting Network” (BIRN) dhe “Qëndresën Qytetare” për zhvillimin e projektit “Mbështetje për pjesëmarrjen, përgjeshmërinë dhe fuqizimin e shoqërisë civile”. I financuar nga Bashkimi Evropian,

komponenti i projektit mbi ndërgjegjësimin për të drejtën e informimit u zhvillua me mbajtjen e takimeve trajnuese në Elbasan, Korçë, Tepelenë, Gjirokastër, Shkodër dhe Lezhë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve lokalë të organizatave të shoqërisë civile apo grupeve të interesit dhe qytetarë. Në fokus ishte nxitja e ndërgjegjësimit dhe promovimi i të drejtës për informim, si dhe rëndësia e procesit të konsultimit publik në kuadër të kontrollit dhe pjesëmarrjes në qeverisje.

- Me tematikën “E drejta e informimit në Shqipëri: vendimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, u zhvillua forumi për trajtimin e veprimtarisë institucionale nga këndvështrimi i studimeve akademike. Në të ishin të pranishëm përfaqësues nga bota akademike, shoqëria civile, si dhe koordinatore për të drejtën e informimit të institucioneve qendrore e të pavarura. Studiuesit ndanë me të pranishmit gjetje të projektit, që ka trajtuar veprimtarinë e institucionit për shqyrtimin e ankesave dhe sidomos, vendimmarrjen e Komisionerit, në funksion të krijimit të praktikës dhe standardeve rregullatore në këtë fushë. Ky aktivitet u mbajt në kuadër të projektit të përbashkët të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, programit Ekspertiza Hulumtuese nga Diaspora Akademike dhe Fakultetit të Drejtësisë së Universitetit të Tiranës.
- Zyra e Komisionerit ka dhënë kontribut aktiv edhe në kuadër të:
 - “Forumit IX për Zhvillimin e Medias”, i organizuar nga Prezenca në Shqipëri e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë;
 - tryezës së përbashkët të Këshillit të Lartë Gjyqësor me mbështetjen e Qendrës për Çështjet e Informimit Publik për diskutimin e “Udhëzuesit standard të marrëdhënies së gjykatës me publikun dhe median”;
 - në aktivitetin e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim për diskutimin e ndryshimeve në ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik;
 - trajnimeve, në bashkëpunim me organizatën “Faktoje”, për Drejtoritë e Përgjithshme të Tatimeve dhe të Doganave;
 - bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim në kuadër të projektit BAT.

VII.4. AKTIVITETE TË TJERA

- Zyra e Komisionerit ishte e ftuar në Forumin e Shoqërisë Civile, të zhvilluar në Tiranë, i mbajtur në vigjilje të Samitit të Liderëve të Procesit të Berlinit për vendet e Ballkanit Perëndimor. Pjesëmarrja e institucionit ishte në panelin me temë “*Tejkalimi i pengesave digjitale*”, me praninë e përfaqësuesve nga institucione rregullatore të rajonit tonë, organizatave ndërkombëtare, shoqërisë civile, rretheve akademike dhe medias. Zyra e Komisionerit prezantoi risitë e legjislacionit të përafuar të mbrojtjes së të dhënave, i cili, ndër të tjera, do të ndikojë në përmirësimin e shërbimeve digjitale dhe do të nxisë zbatimin e standardeve më të larta përsa i përket aspekteve të sigurisë.
- Në përkujtim të 75-vjetorit të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, u zhvillua një tryezë diskutimi nën drejtimin e Prezencës në Shqipëri të OSBE. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të institucioneve publike dhe organizata të shoqërisë civile. Takimi ofroi një mundësi për të rritur ndërgjegjësimin e shoqërisë civile për rolin e saj vendimtar për të promovuar e advokuar zbatimin e rekomandimeve të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut.

- Zyra e Komisionerit është një nga autoritetet përfituese të projektit “Bashkimi Evropian për Qeverisjen e Mirë”, sipas komponentëve:
 - i. forcimin e kapaciteteve institucionale dhe koordinatorëve për të drejtën e informimit për zbatimin efektiv të ligjit nr. 45/2022 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare” dhe ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”;
 - ii. ofrimin e asistencës për të garantuar zbatimin efektiv të Konventës së modernizuar të Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”;
 - iii. mbështetje koordinatorëve për të drejtën e informimit, gjithashtu, institucioneve qendrore dhe vendore, për të përmirësuar trajtimin e kërkesave për informacion për një zbatim më efektiv të ligjit për të drejtën e informimit.

Për zbatimin e projektit, Zyra e Komisionerit ka bashkëpunuar me strukturat përkatëse, në funksion të përmirësimit të performancës institucionale pas miratimit të kuadrit të ri rregullator.

VIII. VEPRIMTARIA JURIDIKE, PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE

VIII.1 AKTE RREGULLATORE

VIII.1.1 Ligji i ndryshuar për të drejtën e informimit

Gjatë vitit 2023, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë finalizuan procesin e konsultimit publik të ndryshimeve të ligjit për të drejtën e informimit, me zhvillimin e takimit përmbyllës ku pjesëmarrës ishin përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, medias, etj.



Në vijim, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 78, datë 21.09.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119 datë 14.09.2014 “Për të drejtën e informimit”. Këto ndryshime/përmirësime synojnë të forcojnë rregullat dhe procedurat e legjislacionit aktual në këtë fushë, duke ofruar zgjidhje optimale në njohjen me informacionin publik, si dhe për të konsoliduar kulturën e përgjegjshmërisë të administratës publike. Gjithashtu, këto ndryshime reflektojnë edhe standardet e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumentet zyrtare” (Konventa 205 e Tromsos).

VIII.1.2 Projektligji për mbrojtjen e të dhënave personale

Projektligji për mbrojtjen e të dhënave personale i përafuara me Rregulloren 2016/679 dhe Direktivën 2016/680 të BE, vijon të jetë në fazën e finalizimit të miratimit të tij. Për shkak të rëndësisë që mbart ky projektligj, si një ligj parakusht për integrimin e vendit, ka qënë i domosdoshëm edhe kontributi i Komisionit Evropian. Gjatë vitit 2023 u zhvilluan takime të përbashkëta midis stafit të Zyrës, Ministrisë së Drejtësisë, ekspertëve të KE dhe atyre të Delegacionit të BE në Tiranë, me qëllim diskutimin dhe arritjen e dakordësisë për projektligjin që do t’i paraqitet Kuvendit për miratim. Zyra e Komisionerit vijon të ketë një rol aktiv në këtë proces dhe vlerëson se miratimi sa më shpejt i tij është një domosdoshmëri.

VIII.1.3 Udhëzimi 463/2020

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme finalizuan procesin e përditësimit të Ankesit I të Udhëzimit të përbashkët nr. 463/2020 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga Shërbimi i Gjendjes Civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”, i ndryshuar në funksion të kërkesave të institucioneve për t’u bërë pjesë e tij.

VIII.1.4 Udhëzuesi “Për përpunimin e të dhënave personale në kontekstin e fushatave zgjedhore”

Zyra e Komisionerit hartoi Udhëzuesin “Për përpunimin e të dhënave personale në kontekstin e fushatave zgjedhore”, miratimi i të cilit përkoi me periudhën përpara nisjes së fushatës elektorale për zgjedhjet vendore 2023. Kjo iniciativë e institucionit vjen si një domosdoshmëri për adresimin e sfidave elektorale në epokën digjitale, ushtrimin e të drejtës së votës nga qytetarët shqiptarë, në harmoni me garantimin e një tjetër të drejte e lirie themelore, mbrojtjen e të dhënave personale. Ky udhëzues është mbështetur në legjisllacionin e BE dhe sidomos, atë të Këshillit të Evropës – *specifikisht, të dokumentit me të njëjtin titull*, ashtu si edhe praktikën më të mirë ndërkombëtare në këtë fushë. Udhëzuesi ka për qëllim orientimin e duhur të subjekteve zgjedhore (parti politike apo kandidatë) mbi mënyrën se si të garantojnë mbrojtjen e të dhënave personale të votuesve. Respektimi i rregullave në këtë proces është thelbësor për të ruajtur besimin e qytetarëve, duke u garantuar kontrollin mbi të dhënat e tyre personale dhe duke siguruar mbarëvajtjen e procesit në të gjitha fazat e tij. Duke marrë në konsideratë rreziqet e mundshme që mund të sjellë përpunimi i paligjshëm i të dhënave personale, Zyra e Komisionerit inkurajon të gjithë subjektet zgjedhore të zbatojnë legjisllacionin e fushës gjatë periudhës së fushatave zgjedhore.

VIII.2 DOKUMENTE STRATEGJIKE

VIII.2.1 Strategjia Institucionale 2022-2025

Në kuadër të Strategjisë Institucionale 2022-2025 dhe Planit të saj të Veprimit, u hartua Raporti i monitorimit të zbatimit të objektivave të parashikuar për periudhën 2022-2023, që korrespondon me 31 masa specifike, ndër të cilat:

- 27 janë realizuar plotësisht;
- 4 janë në proces.

VIII.2.2 Plani i Integritetit 2022-2025

Në kuadër të Planit të Integritetit 2022-2025, u hartua Raporti i monitorimit të zbatimit të objektivave të parashikuara për vitin 2023, që korespondon me 21 masa specifike, ndër të cilat:

- 9 janë realizuar deri në shtator të vitit 2023;
- 12 janë realizuar pjesërisht.

VIII.2.3 Strategji Ndërsektoriale

Zyra e Komisionerit është institucion i përfshirë në disa strategji kryesore ndërsektoriale në vend nëpërmjet objektivave që lidhen me fushën e veprimtarisë e për të cilat është përgjegjëse/mbështetëse në zbatimin e tyre.

- **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030,**

ku institucioni kontribuoi gjatë veprimtarisë së tij për realizimin e sfidës *“Mbrojtja e të dhënave të qytetarëve sipas standardeve më të larta të mbrojtjes së të dhënave dhe forcimi/promovimi i transparencës proaktive me qëllim rritjen e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së autoriteve publike”*, në kapitullin *“Forcimi i të drejtave të njeriut”*.

- **Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur 2022-2026, Planit të Veprimit dhe të Pasaportës së Indikatorëve,**

ku institucioni është përgjegjës dhe përmbushi gjatë veprimtarisë së tij masën 1.1.10: *“Fushata ndërgjegjësuese kombëtare për promovimin e të drejtave të fëmijëve me qëllim parandalimin e viktimizimit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe diskriminimi i fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin”*, nëpërmjet realizimit të aktivitetit 1.1.10.1: *“Fushatë kombëtare ndërgjegjësuese me fokus promovimin e mbrojtjes së të dhënave personale të fëmijës, veçanërisht të fëmijëve viktimë, të fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin, si dhe në sistemin arsimor të vendit (mësues, nxënës, student, staf akademik/administrative)”*.

- **Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023 dhe Plani i Veprimit 2019–2023,**

ku institucioni është përgjegjës dhe kontribuoi gjatë veprimtarisë së tij për përmbushjen e objektivit specifik 4.1: *“Rritja e aksesit të publikut në informacionin ligjor dhe pasurimi i vazhdueshëm i njohurive juridike të tyre në përputhje me nevojat specifike”*.

- **Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe Planin e saj të Veprimit 2020-2023,**

ku institucioni është përgjegjës dhe përmbushi gjatë veprimtarisë së tij 3 masat e parashikuara në objektivin A.1: *“Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion”*. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit ka dhënë kontributin e saj për hartimin e masave të objektivit specifik *“Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike në të gjithë sektorët dhe nivelet”* në draftin e ri të SNKK-së dhe Planin e Veprimit 2024-2030.

- **Agjenda Kombëtare e të Drejtave të Fëmijëve 2021–2026,**

ku institucioni është përgjegjës dhe përmbushi gjatë veprimtarisë së tij objektivin specifik IV.1: *“Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale”*.

- **Kontrata e Mbështetjes Buxhetore për Mirëqeverisjen IPA 2020,**

ku institucioni është përgjegjës dhe përmbushi Indikatorin nr. 7: *“Transparenca e veprimtarisë shtetërore dhe aksesit në informacion për qytetarët”*, me target për 2023: *“Të paktën 25 institucione shtesë përdorin Regjistrin Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën”*.

e Informimit krahasuar me vitin 2022”. Në fund të vitit 2023 numri i autoriteteve publike që kanë funksional REKPMI është 222, pra 27 më shumë se paraardhës.

Njëkohësisht, Zyra e Komisionerit ka dhënë kontribut aktiv në përgatitjen e objektivave/masave/aktiviteteve konkrete gjatë procesit të hartimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2024-2030, Strategjisë Kombëtare e Migracionit 2024-2030 (SKM) dhe Planet e tyre të Veprimit.

VIII.3 PROCESË GJYQËSORE

Gjatë vitit 2023, institucioni ka qenë palë në 42 procese gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lidhur me çështje që kanë objekt zbatimi legjislativ për të drejtën e informimit.

Çështje me objekt zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit”

Procese gjyqësore	42
Rrëzim padie	10
Pranim padie	3
Pushim gjykimi për Zyrën e Komisionerit	2
Pranim i pjesshëm i padisë	4
Çështje e kthyer për mangësi në kërkesë padi	2
Çështje të pezulluara	2
Çështje në proces	19

Nga analizimi i statistikave ndër vite, theksojmë se vendimmarrja e Komisionerit në zbatim të legjislativ për të drejtën e informimit, përgjithësisht, është konfirmuar në rrugë gjyqësore. Ky fakt është pozitiv përse i përket krijimit të jurisprudencës, duke vlerësuar qasjen e Zyrës në këtë fushë në gati një dekadë veprimtari. Por, për shkak të rëndësisë që këto çështje kanë në funksion të interesit publik, përbën shqetësim vonesa në shqyrtimin e tyre nga gjykata. Në praktikë, për qytetarin, kjo tejzgjatje pengon drejtpërdrejtë në marrjen e informacionit dhe humbjen e rëndësisë së tij në raport me kohën. Ndërsa, për institucionin kjo situatë ndikon në pamundësinë e krijimit dhe aplikimit të precedentit në trajtimin e çështjeve me objekt të njëjtë, çka mund të ndikojë edhe në rritjen e kostove administrative.

Nga ana tjetër, shqetësim përbëjnë ato çështje për të cilat vendimmarrja e Komisionerit nuk është konfirmuar në rrugë gjyqësore, edhe këto procese të tejzgjatura në kohë, çka passjell për institucionin rivlerësimin e qëndimit të dhënë më herët, ndërkohë që gjatë kësaj periudhe qasja në trajtimin e rasteve me po të njëjtin objekt ka qenë e njëjtë.

Institucioni ka qenë palë në 24 procese gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për çështje me objekt legjislativ për mbrojtjen e të dhënave personale.

**Çështje me objekt zbatimin e ligjit
“Për mbrojtjen e të dhënave personale”**

Procese gjyqësore	24
Rrëzim padie	11
Pranim i pjesshëm i padisë	2
Çështje në proces	10
Çështje të pushuara	1

Zyra e Komisionerit është palë në 73 procese gjyqësore për çështje ndër vite në shqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Gjatë vitit 2023, kjo gjykatë është shprehur me vendim vetëm për 2 çështje.

IX. MENAXHIMI BUXHETOR

IX.1 STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Bazuar në kompetencat e shtuara rregullatore në të dy fushat e përgjegjesisë, Vendimi i Kuvendit të Republikës të Shqipërisë, nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar me Vendimin nr. 24/2023, miratoi strukturën dhe organigramën e Zyrës së Komisionerit. Ndër elementët kryesore të këtyre ndryshimeve përmëndim shtimin e njësive të reja, si:

- Drejtoria e Mbikëqyrjes në Fushën e Drejtësisë Penale dhe Sigurisë Publike, e cila është përgjegjëse për zbatimin e ligjit në këtë sektor, të cilit BE i ka rezervuar një Direktivë të posaçme;
- Njësia e Auditit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, detyrat dhe funksionet e së cilës janë garantimi i standarteve dhe cilësisë të veprimtarisë së punës në zbatimin e legjislacionit të fushës dhe të analizës së ndikimit në të dhënat personale (data protection impact assesment);
- Sektori i posaçëm me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.

Me qëllim përgjigjen ndaj rritjes së fluksit të punës në terma cilësorë dhe sasiorë dhe që diktohen nga detyrat që burojnë nga modernizimi i legjislacionit, me ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, Zyrës së Komisionerit ju miratua një numër total prej 60 punonjësish.

Gjatë vitit 2023, për plotësimin e vendeve vakante në strukturën organizative u zhvilluan procedurat respektive për rekrutimin e nëpunësve me integritet dhe aftësitë e duhura profesionale, proces i cili është në vazhdimësi.

Në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve profesionale janë ndjekur trajnimet periodike në bashkëpunim me ASPA dhe me partnerë të huaj, sipas fushave të përgjegjesisë. Gjithashtu, stafi ka marrë pjesë edhe në trajnime të organizuara nga organizata publike/jopublike vendase apo të huaja, duke bërë të mundur shkëmbimin e eksperiencës dhe njohjen me praktikat më të mira.

IX.2 MENAXHIMI I BUXHETIT

Me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe me ndryshimet nga Aktet Normative gjatë vitit, fondet e akorduara për Zyrën e Komisionerit ishin në vlerën **110.322** (në mijë). Realizimi faktik i buxhetit është në vlerën **108.335** (mijë lekë), ose në nivelin **98.1%**. Pjesën qendrore të shpenzimeve buxhetore e përbëjnë pagat, realizuar në vlerën 70.177 (në mijë lekë) ose 99.7% dhe kontributet për sigurimet shoqërore/shëndetësore, realizuar në shumën 11.014 (në mijë lekë) ose 98.9%.

BUXHETIT DHE REALIZIMI

000/Lekë

Nr.	Emërtimi	Plan Vjetor 2023 (i ndryshuar)	Struktura në % kundrejt totalit	Fakti Vjetor	% realizimi kundrejt planit vjetor për kategori
1	Paga	70.382	64%	70.177	99.7%
2	Sigurime shoqërore	11.130	10%	11.014	98.9%
3	Mallra e shërbime të tjera	22.220	20%	20.738	93%
4	Investime	6.000	5.4%	6.000	100%
5	Transferta te buxhetet familjare	240	0.2%	240	100%
6	Kuotizacion	100	0.01%	66	67%
7	Fondi i veçantë	250	0.02%	100	40%
	Totali	110.322		108.335	98.1%

Shpenzimet korrente janë realizuar në vlerën 20.738 (në mijë lekë) ose 93%, zë në të cilin përfshihen edhe një pjesë e shpenzimeve për organizimin e Konferencës së 15-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit, e cila do të mbahet në Tiranë, në datat 3-5 qershor 2024. Në funksion të zhvillimit normal të veprimtarisë institucionale, një pjesë e aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe sigurimi i infrastrukturës së nevojshme, janë financuar nga donacionet të akumuluar nga vitet paraardhëse.

IX.3 ARKËTIME NGA SANKSIONET

Për vitin 2023 sanksionet administrative e vendosura janë në shumën **5 135 000** lekë. Ekzekutimi i sanksioneve arkëtohet 100% në buxhetin e shtetit, duke u shlyer vullnetarisht ose nëpërmjet shërbimit përbarimor.

Totali i sanksioneve në vitin 2023	5 135 000
Për shkelje të dispozitave ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale	4 860 000
Për shkelje të dispozitave të ligjit për të drejtën e informimit	275 000

Për vitin 2023, shuma totale e arkëtimit të sanksioneve administrative është 1 310 000 lekë, e cila ndahet në 810 000 lekë për sanksionet e vendosur në vitin 2023 dhe vlera 500 000 lekë për sanksionet e mbartura nga vitet paraardhëse.